



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 515 Akti

Nr. 613 Vendimi
Tiranë, më 16.1.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 13.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Paulin Çera**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Paulin Çera, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Paulin Çera, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në qershor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Paulin Çera do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Paulin Çera, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit, në datën 22.12.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Paulin Çera; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit në datën 4.1.2023.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Paulin Çera në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Subjekti i rivlerësimit Paulin Çera u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 9.1.2023.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 13.1.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Paulin Çera kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

12. Z. Paulin Çera ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

14.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

14.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 konstatohet se për subjektin Paulin Çera:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

18. Z. Paulin Çera është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2014 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2014; (ii) periodike/vjetore për vitet 2014 – 2016; si dhe (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklarinimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

20. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Paulin Çera, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 30.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2014 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguara nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Paulin Çera ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Tokë bujqësore

1.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar 14 dynym tokë bujqësore, e mbjellë pemëtari, ndodhur në fshatin T, Njësia Administrative S, Bashkia Peshkopi.

1.2 Burimi i krijimit: një pjesë e regjistruar në emër të të ndjerit R.Ç, ndërsa 6 dynym janë dhënë në përdorim nga Komuna S.

1.3 Për të provuar deklarinimin subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatën familjare për përbërjen familjare të periudhës 1974 – 1.8.1991, me kryefamiljar R.Ç, së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët, ku ndër të tjerë figuron edhe shtetasi N.Ç (babai i subjektit) dhe subjekti Paulin Çera.

1.4 ZVRPP-ja Dibër² nuk konfirmon pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

1.5 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës 2014, subjekti ka deklaruar: “14 dynym tokë bujqësore e mbjellë pemëtari, ndodhur në fshatin T, Komuna S. Burimi: 8 dynym tokë janë përfituar nga ligji nr. 7501 dhe të regjistruara, ndërsa 6 dynym janë dhënë në përdorim nga Komuna S”.

1.6 Subjekti deklaroi se toka bujqësore me sipërfaqe 8 dynym në S, Peshkopi, e përfituar me ligjin nr.7501, është e regjistruar në emër të shtetasit R.Ç (gjyshi), si dhe 6 dynym tokë janë dhënë në përdorim.

1.7 Nisur nga fakti se nuk provohet mënyra e fitimit të kësaj prone, pjesa takuese e subjektit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime sipas pyetësorit³.

1.8 Në përgjigje të pyetësorit⁴, subjekti deklaroi se: “Gjyshi, i ndjeri R.M.Ç, ka të regjistruar në ZVRPP-në Dibër në emër të tij pasuri të paluajtshme 8,450 m². Për këtë pasuri nuk janë kryer procedurat e kalimit të trashëgimisë, por faktikisht posedohet nga babai im N.Ç.

Në muajin shkurt të vitit 2010 kam insistuar personalisht që kjo sipërfaqe toke bujqësore të kthehej në pemëtari. Kemi komunikuar me shtetasin A.Z, i regjistruar në QKB si person fizik, me objekt veprimtarie ‘Prodhim dhe tregtim fidanësh etj.’, të cilit i kam blerë 842 rrënjë fidanë

²Shihni përgjigjen e ASHK-së në dosjen e ILDKPKI-së dhe Komisionit.

³Shihni pyetësorin nr. *** dërguar subjektit të rivlerësimit.

⁴Shihni përgjigjen e subjektit për pyetësorin nr. *** të datës 17.7.2022.

të varieteteve mollë dhe dardhë, kundrejt një çmimi prej 100,000 lekësh. Këtë shumë ia kam likuiduar personalisht në datën 17.5.2010.

Më pas, babai N.Ç ka përfituar subvencione në bujqësi dhe kjo provohet me vërtetimin e datës 17.4.2018, lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë Dibër.

*Me aktekspertizën nr. *** prot., datë 17.9.2020, të përgatitur nga Sektori Ekstensionist Bujqësor Dibër, provohet gjendje aktuale faktike e kësaj pemëtarie në të gjithë komponentët e vlerësimit.*

Gjithashtu, për të provuar gjendjen aktuale faktike të kësaj pemëtarie, do të paraqes në cilësinë e provës fotografitë e tokës, si dhe një fotografi ajrore.

Deri në këto momente të ardhurat nga ky aktivitet janë përftuar nga babai dhe familjarët e tjerë që jetojnë me të në fshat. Megjithatë, me dakordësinë e babait tim, për shkak edhe të investimit tim, unë do të përfitoja 25% të të ardhurave. Deklaroj se unë nuk kam të drejta pronësie mbi tokën, pasi formalisht nuk ka një akt të tillë”.

1.9 Bazuar në provat e dërguara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit dhe konkretisht në përgjigjen e ZVRPP-së Dibër me nr. *** prot., datë 19.4.2018, rezulton se shtetasi R.M.Ç ka të regjistruar një pasuri të paluajtshme me sip. 8,450 m².

1.10 Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 18.4.2018, të Bashkisë Dibër, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka në përdorim 14,000 m² sipërfaqe tokë bujqësore.

1.11 Bazuar në konfirmimin e Bashkisë Dibër nuk provohet deklarimi i subjektit se ka të drejta pasurore për 14 dynym, ku rezultoi se vetëm një pjesë është e regjistruar në emër të të ndjerit R.Ç, ndërsa 6 dynym janë dhënë në përdorim nga Komuna S.

1.12 Referuar shkresës nr. ***, datë 17.4.2018, të Drejtorisë së Bujqësisë Dibër, rezulton se babai i subjektit ka përfituar subvencione në bujqësi për vitet 2010 – 2012, në vlera të ndryshme financiare. Shpenzimet e deklaruara të kryera nga subjekti (kryer në vitin 2010 kur nuk ka qenë subjekt rivlerësimi) janë përfshirë në analizën financiare.

Konkluzion i Komisionit

1.13 Në përfundim të hetimit Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë, të dokumentojë dhe të provojë si është përfituar dhe kur është përfituar sipërfaqja e pretenduar prej 6 dynym tokë bujqësore, dhënë në përdorim nga Komuna S.

➤ Për konstatimin e mësipërm të bërë nga Komisioni për këtë pasuri, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumentacion provues.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.14 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Në vitin 2010 unë dhe familja ime kemi rënë dakord që sipërfaqen prej 8,450 m² ta kthejmë në pemëtarie. Kemi blerë 842 rrënjë fidanë, të varieteteve mollë dhe dardhë, kundrejt një çmimi prej 100,000 lekësh. Këtë shumë e kam likuiduar personalisht në datën 17.5.2010, pas marrjes së një overdrafti në ‘Raiffeisen Bank’.*

Për shkak të investimit tim modest, në deklaratat periodike të pasurive, në atë Vetting, por edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguara nga Komisioni, kam deklaruar se për këtë pasuri të paluajtshme konsideroj interesa. Interesat në këtë rast lidhen vetëm me pjesën e investimit dhe jo të pasurisë së paluajtshme, pasi formalisht nuk ka ndonjë akt për të provuar pronësinë. Për

më tepër, babai im N.Ç ka pranuar investimin tim, duke u shprehur se tre djemve iu ka premtuar nga 25% pjesë⁵.

Sqaroj komisionin se sipërfaqja prej 8,450 m² është e regjistruar rregullisht në emër të gjyshit tim R.Ç, e cila posedohet nga babai im N.Ç. Trashëgimtarët e tjerë ligjorë Z. Ç dhe D.L nuk kanë pasur, nuk kanë dhe nuk do kenë pretendime në të ardhmen. Sipërfaqja prej 6,000 m² është përfituar nga ish-Komuna S, sot Njësia Administrative S, Bashkia Peshkopi, në formën e përdorimit, me anë të shkresave zyrtare dhe, për më tepër, e pranuar kjo edhe në vijimësi nga organe të tjera shtetërore, të cilat kanë miratuar subvencionet. Kjo tregon se babai im e ka marrë dhe poseduar në mënyrë të ligjshme këtë sipërfaqe”.

➤ Për të provuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës⁶.

Vlerësimi i Komisionit

1.15 Trupi gjykues, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundimin se shpjegimet e tij ishin shteruese. Rezultoi se kjo pasuri është përfituar nga gjyshi i subjektit R.Ç dhe posedohet nga babai i subjektit N.Ç. Nga kjo pasuri 8 dynym tokë janë përfituar nga ligji nr. 7501 dhe të regjistruara, ndërsa 6 dynym janë dhënë në përdorim nga Komuna S. Kjo pasuri është përfituar nga gjyshi dhe babai i subjektit shumë kohë para fillimit të detyrës së subjektit si magjistrat.

Subjekti ka bërë deklaram të saktë për këtë pasuri.

2. Automjet tip “****”

2.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* automjet tip “****”, blerë në datën 23.1.2014.

Burimi i krijimit: blerë me kursimet e subjektit. Vlera: 2,150 euro (1,400 euro sipas kontratës). Pjesa takuese: 100%.

2.2 Për të provuar deklaramet subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës një kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 23.1.2014, me palë shitëse A.Xh dhe palë blerëse Paulin Çera. Sipas kësaj kontrate vlera për blerjen e automjetit tip “****” është 1,400 euro.

2.3 Drejtoria e Transportit Rrugor, me shkresat datë 18.7.2017 dhe datë 2.8.2017⁷ dhe shkresën nr. *** prot., datë 1.7. 2022⁸, konfirmon automjetin me targa AA ***, në emër të z. Paulin Çera.

2.4 Bazuar në kontratën e shitblerjes vlera e automjetit rezultoi 1,400 euro. Sipas deklaramit të subjektit kjo pasuri është blerë në vlerën 2,150 euro.

Analiza financiare

2.5 Në analizën financiare, vlera e shpenzuar për blerjen e automjetit është llogaritur 2,150 euro, sipas deklaramit të subjektit.

2.6 Është analizuar periudha para fillimit të detyrës për të parë mundësinë e krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës.

⁵Shihni deklaratën noteriale në vijim.

⁶Deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.12.2022; deklaratë noteriale nr. ***, datë 29.12.2022; deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.7.2022; deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.9.2020; vërtetim nr. *** prot., datë 18.4.2018, Njësia Administrative S, Bashkia Dibër; vërtetimin nr. *** prot., datë 27.12.2022, Njësia Administrative S, Bashkia Dibër; vërtetim datë 28.12.2022, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Dibër; shkresë nr. *** prot., datë 17.4.2018, Drejtoria e Bujqësisë Dibër; shkresë nr. *** prot., datë 25.6.2021, Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

⁷Shihni përgjigjet e DPSHTRR-së në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸Shihni përgjigjet e DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

2.7 Në këtë analizë financiare, si pasuri u përfshinë likuiditetet bankare me gjendje deri në datën 30.10.2014 (kur subjekti emërohet në detyrë), si dhe automjeti tip “****” i blerë në datën 23.1.2014, sipas kontratës nr. ***.

2.8 Tek detyrimet përfshihet vlera e detyrimit të mbetur nga kredia që subjekti kishte pranë “Societe Generale Albania” të marrë në vitin 2013 në vlerën 500,000 lekë.

2.9 Tek të ardhurat u përfshinë të ardhurat e subjektit nga viti 2010 deri në datën 30.10.2014, si dhe të ardhurat e bashkëshortes së tij që nga data e martesës (4.10.2013) deri në datën 30.10.2014.

2.10 Gjithashtu, në këtë analizë u përfshinë edhe shpenzimet e subjektit dhe më vonë të bashkëshortes dhe fëmijës së tij nga viti 2010 deri në datën 30.10.2014.

Analiza financiare për periudhën 2010 – 30.10.2014

PËRSHKRIMI	Periudha 2010 – 30.10.14
PASURI	727,736
Automjet “****”, AA *** - 2014 - 100% - 2,150 euro	301,237
Gjendje likuiditete, datë 30.10.2014	426,499

DETYRIME	385,119
Kredi “Societe Generale Albania” - 500,000 lekë - 2013	385,119

PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	342,616
--	----------------

TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA	3,496,931
Të ardhura nga puna, subjekti Paulin Çera	2,599,966
Të ardhura nga puna, bashkëshortja B. Ç	496,965
Të ardhura nga pasuri paramartesore, bashkëshortja	400,000

SHPENZIME	1,264,403
Shpenzime jetese	1,056,564
Shpenzime interes kredi “Raiffeisen Bank” 2012 – 2013 - 200,000 lekë	18,209
Shpenzime interes kredi “Societe Generale Albania” - 500,000 lekë	89,631
Shpenzuar për blerje fidanësh për tokën bujqësore - 2010	100,000

Analiza dokumentuar	1,889,911
----------------------------	------------------

2.11 Bazuar në analizën financiare, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin mundësi financiare për krijimin e pasurive, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve deri në datën e fillimit të detyrës.

2.12 Bazuar në të dhënat e sistemit TIMS lidhur me hyrje-daljet e subjektit jashtë vendit ato janë kryer kryesisht me automjetet në pronësi të subjektit.

2.13 Bazuar edhe në përgjigjen e AMF-së nuk u konstatuan përdorime të automjeteve të tjera në pronësi, përdorim apo si mbajtës i policës së sigurimit nga subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur.

2.14 Subjekti ka deklaruar vlerën e blerjes së kësaj pasurie (2,150 euro) më shumë se çmimi i blerjes sipas kontratës së shitblerjes (1,400 euro). Për këtë iu kërkua subjektit të japë shpjegime lidhur me mosrakordimin e vlerës së blerjes me vlerën e deklaruar prej tij.

2.15 Në përgjigje të pyetësorit⁹, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *“Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 23.1.2014, kam blerë automjetin ‘***’, viti i prodhimit 2000, në shumën 1,400 euro. Në vlerën që është marrë mjeti ka pasur nevojë për shërbime, si dhe për targim, ndaj kam shpenzuar edhe shumën 750 euro. Duke qenë se këto shpenzime janë bërë menjëherë pas marrjes së mjetit, e kam deklaruar në vlerën 2,150 euro, në të cilën përfshihet shuma 1,400 euro sipas kontratës dhe 750 euro të shpenzuar mbi të, sikurse janë lyerje, shërbime mekanike dhe targim. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, si dhe në deklaratat periodike/vjetore, vlerën e mjetit e kam deklaruar në shumën 2,150 euro, duke përfshirë sipas meje përveç blerjes edhe shpenzimet e kryera për të. Në deklaratën Vetting, për këtë mjet jam shprehur si vijon: 2,150 euro (1,400 euro sipas kontratës). Kjo pasaktësi në deklaram ka qenë si pasojë e moskuptimit tim lidhur me mënyrën e plotësimit të deklaratave të pasurisë, për shkak se kam qenë në vitet e para të fillimit të detyrës”.*

Konkluzion i Komisionit

2.16 Në përfundim të hetimit Komisioni konstatoi se subjekti ka një pasaktësi në deklarin e vlerës së kësaj pasurie automjet. Deklarimet e subjektit lidhur me shpenzimet e kryera për këtë automjet nuk u provuan me dokumentacion provues, duke mbetur në kuadrin deklarativ. Për këtë konstatim të bërë nga Komisioni iu kërkua subjektit të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumentacion provues, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.17 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 23.1.2014, kam blerë automjetin ‘***’, viti i prodhimit 2000, në shumën 1,400 euro. Në vlerën që është marrë, mjeti ka pasur nevojë për shërbime si dhe për targim, ndaj kam shpenzuar edhe shumën 750 euro. Duke qenë se këto shpenzime janë bërë menjëherë pas marrjes së mjetit, e kam deklaruar në vlerën 2,150 euro, në të cilën përfshihet shuma 1,400 euro sipas kontratës dhe 750 euro të shpenzuar mbi të sikurse janë lyerje, shërbime mekanike dhe targim. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, si dhe në deklaratat periodike/vjetore, vlerën e mjetit e kam deklaruar në shumën 2,150 euro, duke përfshirë sipas meje përveç blerjes edhe shpenzimet e kryera për të. Në deklaratën Vetting, për këtë mjet jam shprehur si vijon: 2,150 euro (1,400 euro sipas kontratës)”.*

*Sikurse e kam pranuar në përgjigje të pyetësorit nr. ***, deklarimi i vlerës 2,150 euro ka qenë pasaktësi në deklaram, ardhur si pasojë e moskuptimit tim lidhur me mënyrën e plotësimit të deklaratave të pasurisë, për shkak se kam qenë në vitet e para të fillimit të detyrës. Në deklaratën Vetting, këtë shumë jam përpjekur ta ndaj, konkretisht 1,400 euro blerje sipas kontratës dhe 750 euro shpenzimet e kryera mbi të.*

Si konkluzion, sqaroj Komisionin se deklarimi i vlerës 2,150 euro ka qenë pasaktësi në deklaram, ardhur si pasojë e moskuptimit tim lidhur me mënyrën e plotësimit të deklaratave të pasurisë, për shkak se kam qenë në vitet e para të fillimit të detyrës. Duke qenë se ka kaluar kohë e gjatë, nuk disponoj dokumentacion për shpenzimet që i kam kryer makinës. Gjithsesi, sjell në vëmendje se tashmë këtë mjet e kam shitur më pak sesa e kam blerë apo deklaruar”.

⁹Shihni përgjigjen mbi pyetësorin nr. *** në dosjen e Komisionit.

- Për të provuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur dokumentacion përkatës¹⁰.

Vlerësimi i Komisionit

2.18 Për të gjitha argumentet e paraqitura më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti kishte mundësi për blerjen e automjetit dhe shpenzimet e tjera të kryera prej tij, pavarësisht deklarimit jo të saktë në lidhje me vlerën e blerjes së automjetit në vitin 2014 dhe mungesën e dokumentacionit për shpenzimet e kryera për këtë automjet.

Trupi gjykues vlerëson se në rastin e deklarimit të vlerës së automjetit nuk ka të bëjë me pasaktësi, në kuptim të detyrimit të ligjit për deklarim, që të mund të afektojë subjektin dhe vendimmarrjen për të.

3. Llogari bankare në emër të subjektit në “Raiffeisen Bank” dhe “Alpha Bank”

3.1 Subjekti ka deklaruar llogarinë bankare nr. *** - ALL pranë “Raiffeisen Bank”. Gjendja për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2016 në vlerën 5,623,913.42 lekë. Burimi i krijimit: Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të ardhura nga familja. Pjesa takuese: 100%.

3.2 Subjekti, për të vërtetuar deklaratën e tij, ka paraqitur një vërtetim mbi produktet bankare nga “Raiffeisen Bank”, ku rezulton se për vitet 2010 – 2016 është kredituar në total shuma prej 5,623,912 lekësh.

3.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën e datës 10.7.2017¹¹ dhe shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2022, konfirmon llogarinë rrjedhëse nr. ***-ALL, në emër të z. Paulin Çera. Gjendja e llogarisë në datën 30.1.2017 ka qenë në shumën -239,891 lekë.

3.4 Dokumentacioni i paraqitur nga banka konfirmon deklarimin e subjektit, e cila është një llogari rrjedhëse ku është bërë kalimi i pagës së subjektit ndër vite.

3.5 Subjekti ka deklaruar llogari bankare pranë “Alpha Bank”, me nr. ***. Gjendja nga për periudhën 1.6.2016 – 20.1.2017 është në vlerën 580,623.85 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Pjesa takuese: 100%.

3.6 Për të provuar deklarimet e tij subjekti ka paraqitur dokumentin “Nxjerrje llogarie ‘Alpha Bank’”, ku rezulton se gjatë periudhës qershor 2016 – janar 2017 janë kredituar pagat në vlerën totale 580,623 lekë dhe se gjendja e llogarisë është në vlerën 24,286 lekë.

3.7 “Alpha Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2017, konfirmon llogari me nr. *** , në emër të z. Paulin Çera, me gjendje në datën 30.1.2017 në vlerën 24,286 lekë.

Konkluzioni i Komisionit për këto dy llogari bankare

3.8 Në përfundim të hetimit rezultoi pasaktësi në deklarim, pasi subjekti ka deklaruar vlerën e të gjitha të ardhurave në këto llogari bankare dhe jo gjendjen e llogarive në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, por kjo pasaktësi nuk ndikon në vlerësimin përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë dhe detyrimeve që subjekti ka pasur për të deklaruar.

4. Kredi bankare

4.1 Subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie bankare në “Societe Generale Albania” me kontratën nr. ***. Shuma e kredisë së marrë është 500,000 lekë. Shuma e mbetur e pashlyer deri në datën 19.1.2017 është 156,123.6 lekë. Në datën 29.12.2015 është paguar kësti i 32-të.

4.2 Për këtë kredi rezultoi një kontratë kredie nr. *** , datë 18.4.2013, me palë kredidhënëse “Societe Generale Albania” dhe palë kredimarrëse Paulin Çera dhe B.M. Shuma e kredisë së

¹⁰Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** , datë 16.11.2020 dhe faturë tatimore shitjeje nr. serie *** , datë 16.11.2020.

¹¹Shihni përgjigjen e bankës në dosjen e ILDKPKI-së.

marrë nga subjekti është 500.000 lekë + planamortizimi i kredisë. Gjendja e kredisë në datën 19.1.2017 është në vlerën 156,123 lekë.

4.3 Kjo kredi është marrë nga subjekti para fillimit të detyrës si magjistrat, kredi e cila vazhdon të shlyhet nga subjekti. Shuma e kredisë dhe likuidimet e saj ndër vite janë pasqyruar në analizën financiare.

4.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë kredi bankare.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT, ZNJ. B. Ç

5. Llogari bankare në BKT

5.1 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar llogarinë bankare nr. *** në BKT.

5.2 Burimi i krijimit: të ardhura nga punësimi në Drejtorinë Arsimore Rajonale Dibër, në vlerën 1,927,478.88 lekë; të ardhura të realizuara në cilësinë e personelit akademik me kohë të pjesshme pranë universitetit “****”, Durrës, për vitin akademik 2011 - 2012, në vlerën 34,020 lekë.

5.3 Për të provuar deklaratimet e saj, janë paraqitur si prova:

- vërtetim i DRRSH-së Dibër, ku vërtetohen të ardhurat *bruto* dhe *neto* të znj. B.M për periudhën shtator 2012 – dhjetor 2016;
- vërtetim i DRSSH-së Dibër, ku vërtetohen të ardhurat për barrëindjen për periudhat prill 2014 – prill 2015 dhe nëntor 2015 – maj 2016;
- vërtetim të ardhurash nga universiteti “****”, Durrës, për znj. B. M, për periudhën janar – dhjetor 2012, në vlerën 34,020 lekë.

5.4 Bazuar në ekstraktin nxjerrje llogarie në BKT rezultoi se znj. B.Ç kreditohet nga paga si arsimtare dhe raportet e lejes së lindjes për periudhën shtator 2012 e vazhdim, në vlerën totale 1,927,478 lekë.

Konkluzion i Komisionit

5.5 Në përfundim të hetimit rezultoi se të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga pagat dhe raporti i lejes së lindjes janë në vlerën totale 1,757,480 lekë deri në dhjetor të vitit 2016.

Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaratim të saktë për të ardhurat në këtë llogari bankare, por nuk ka deklaruar gjendjen e tyre në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

Pavarësisht detyrimit për deklaratim të saktë të pasurive, ashtu sikurse ligji nr. 9049/2003 ka parashikuar, Komisioni vlerësoi se kjo pasaktësi nuk ndikon dhe nuk mund të shërbejë si rrethanë negative në lidhje me vlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

ÇËSHTJE TË TJERA

6. Adresat e banimit

6.1 Në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe deklaratat e interesave privatë ndër vite, subjekti ka deklaruar si adresë:

- Njësia Administrative S, fshati T, Peshkopi;
- Njësia Bashkiake K, rruga “****”, pallati “****”, ap. ***, Tiranë.

6.2 Adresa e Njesisë Administrative S, fshati T, Peshkopi, rezulton adresa e vendlindjes dhe origjinës së subjektit, si dhe të regjistrimit në njësinë përkatëse administrative.

6.3 Adresa e Njesisë Bashkiake K, rruga “****”, pallati “****”, ap. ***, Tiranë, rezultoi se është adresa e banimit të subjektit në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

6.4 Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi apo përdorim (detyrim ky i ligjit nr. 84/2016).

6.5 Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se për periudhën kur ka ushtruar detyrën e gjyqtarit (tetor 2012 – janar 2017) ka qëndruar në adresën: rruga “****”, pallati “****”, shkalla nr. ***, ap. ***. Apartamenti ka qenë në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator shtetasin F.B. Përdorimi i këtij apartamenti ka qenë pa qira.

6.6 Subjekti i rivlerësimit u pyet¹² në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie si pasuri në përdorim në deklaratën *Vetting*, si dhe raportin e tij me këtë pasuri dhe pronarët.

6.7 Në përgjigje të pyetësorit¹³, subjekti deklaroi: “*Kolegji i Posaçëm i Apelit në praktikën e tij ka dhënë përkufizimin se kush janë të drejtat reale për të cilat subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për t’i deklaruar në deklaratat e pasurisë.*”

*Mbështetur në arsyetimin e bërë, deklaroj se gjatë periudhës së deklarimit nuk kam përdorur pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të personave të tjerë, pasi nuk kam fituar të drejtat reale me ndonjë kontratë noteriale sipas parashikimeve të Kodit Civil e që është objekti i deklarimit sipas deklaratës së pasurisë *Vetting*, e cila është miratuar me ligjin nr. 84/2016 dhe nenit 3, pika 11 e këtij ligji.*

*Ndodhur në këto kushte, duke mos pasur ndonjë të drejtë reale mbi apartamentin në pronësi të shoqërisë ‘***’ në qytetin e Tiranës, nuk mund ta deklaroja në deklaratën e pasurisë *Vetting* si përdorim në rubrikën e deklarimit të ‘të drejtave reale të përdorimit apo banimit’ sipas Kodit Civil.*

*Marrëdhëniet e mia me shtetasin F.B, administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., janë marrëdhënie shoqërore për shkak se jemi nga e njëjta zonë.*

Nga muaji nëntor 2012 deri në muajin janar 2017 kam qëndruar në adresën e sipërcituar.

Në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur kryesisht duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

*Unë dhe personat e lidhur me mua (bashkëshortja e fëmijët) gjatë periudhës së deklarimit nuk kemi qenë në kushtet e një marrëdhënieje dhurimi apo huaje me ortakët apo administratorin e shoqërisë ‘***’, si dhe vetë këtë të fundit, për rrjedhojë nuk ndodhem në kushtet e një interesi pasuror në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet ‘person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit’.*

*Deklaroj se me ortakët apo administratorin e shoqërisë ‘***’, si dhe vetë këtë të fundit, nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk i kam gjykuar kurrë gjatë ushtrimit të detyrës time si gjyqtar”.*

6.8 Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, konkretisht vërtetimin e datës 8.7.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 12.7.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka pasur çështje gjyqësore me ortakët apo administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k.

6.9 Rezultoi se pallati “****”, Tiranë, është ndërtuar me lejen e ndërtimit nr. *** prot., datë 24.11.2005 nga shoqëria “****” sh.p.k., ndërkohë që aktkolaudimi që provon përfundimin e këtij pallati rezulton se punimet kanë qenë të përfunduara në datën 25.8.2008. Gjithashtu

¹²Shihni pyetësorin nr. *** dërguar subjektit të rivlerësimit.

¹³Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr.***.

rezulton se për këtë apartament është lëshuar certifikata e pronësisë nr. ***, datë 28.7.2010. Për këtë apartament, pasi subjekti i rivlerësimit nuk e ka përdorur më këtë pasuri, është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 27.4.2017, me shitës shoqëria “****” sh.p.k. dhe blerës M.Gj, në vlerën 27,500 euro.

6.10 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje u konstatua se objekti ndërtimor është ndërtuar nga shoqëria “****” dhe apartamenti i përdorur nga subjekti është regjistruar në emër të kësaj shoqërie, e cila duket se është shitur më pas në vitin 2017.

6.11 Subjekti është pyetur që të provojë periudhën e përdorimit, si dhe pagimin e detyrimeve ndaj të tretëve, OSHE-së dhe UKT-së. Në përgjigje të pyetësorit¹⁴, subjekti ka deklaruar: “Nga viti 2012 deri në vitin 2017, unë së bashku me familjen time kemi banuar pa qira në një apartament në pronësi të shoqërisë ‘****’ sh.p.k., ndodhur në qytetin e Tiranës.

Deklaroj se gjatë kohës së qëndrimit tim dhe familjarëve të mi në këtë apartament, nga fundviti 2012 deri në fillim të vitit 2017 kam kryer me shpenzimet e mia pagesën e energjisë elektrike, sipas konsumit mujor. Deklaroj se nuk kam kryer pagesën e ujësjellës-kanalizimeve, pasi pallati ku unë banoja furnizohej me ujë pusi. Përveç pagesës së energjisë elektrike mujore, unë nuk kam kryer ndonjë shpenzim tjetër që lidhet me këtë njësi banimi. Librezën e pagesës së energjisë elektrike nuk e disponoj, pasi atë ia kam dorëzuar pronarit të apartamentit në momentin që jam larguar.

*Ky deklaram provohet me deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.10.2022, me deklaruës z. F.B.*

*Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.10.2022, Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., në përgjigje të shkresës time të protokolluar me nr. *** prot., datë 14.10.2022, ka sqaruar si vijon: ‘Kontrata nr. ***, me kod klienti ***, i përket aktualisht abonentit M. N.Gj. Kontrata është hapur në datën 31.5.2008 në emër të firmës ‘****’. Ndryshimi i emrit nga firma ‘****’ në M. Gj është ekzekutuar në sistem në datën 8.5.2017. Referuar sistemit të faturimit detyrimet nga muaji dhjetor 2012 deri në muajin shkurt 2017 janë të shlyera’.*

*Me shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2022, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a., në përgjigje të shkresës së bërë ka dhënë sqarimet e saj. Bashkëlidhur do të gjeni këto prova përkatëse”.*

Konkluzion i Komisionit

6.12 Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në përdorim në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* në përputhje me nenin 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016.

6.13 Shpjegimet e subjektit se me pronarin ka marrëdhënie shoqërore se janë nga e njëjta zonë, nuk duken bindëse për Komisionin. Pavarësisht se nuk u konstatua konflikt interesi i subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., e cila i ka lënë në përdorim pa kundërshtëpërblim pasurinë apartament subjektit të rivlerësimit për një periudhë 5-vjeçare, linden dyshime si subjekti e ka përdorur gjithë këto vite gjatë kohës së ushtrimit të detyrës një pasuri të tillë pa kundërshtëpërblim.

6.14 Subjekti në vitin 2016 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në qytetin e Durrësit dhe ka përdorur këtë pasuri në qytetin e Tiranës, gjë që për Komisionin nuk duket e përshtatshme përdorimi nga magjistrati pa kundërshtëpërblim i një pasurie të një personi jo në rrethin familjar për një periudhë 5-vjeçare pa ndërprerje.

6.15 Gjithashtu, për Komisionin nuk duket bindës as deklarimi për moskryerjen e shpenzimeve (shpenzime mobilimi, arredimi dhe për pajisje familjare) nga ana e subjektit lidhur me këtë pasuri në përdorim për një periudhë 5-vjeçare.

¹⁴Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. **** në dosjen e Komisionit.

6.16 Subjekti nuk arriti të provojë periudhën e qëndrimit të tij në këtë apartament dhe as të provojë shpenzimet e kryera prej tij si përdorues i kësaj pasurie ndaj palëve të treta.

6.17 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2022, të UKT-së Tiranë, rezulton se për vitet 2012 – 2017 është paguar (pagesa edhe nëpërmjet shërbimit postar) shuma në total ndaj këtij institucioni prej 11,790 lekësh. Kjo shkresë rrëzon pretendimet e subjektit që nuk janë kryer pagesa ndaj UKT-së. Edhe nëse pretendimi i subjektit do të qëndrojë lidhur me furnizimin me ujë pusi, ai nuk arriti të provojë shpenzimet e kryera për këtë shërbim gjatë viteve 2012 – 2017.

6.18 Subjekti ka disponuar dhe përdorur pa kundërshtëpërblim (përdorim falas) pasurinë apartament për gati 5 vjet, duke mos paguar as qira për përdorimin e saj. Pra, duket se nga ana e pronarit të pasurisë apartament i është “dhuruar” shuma financiare përkatëse (shumë për të cilën subjektit duhet të paguante qira mujore për periudhën e përdorimit, mesatarisht në vlerën 20,000 lekë/muaj) dhe nga ana e subjektit nuk është deklaruar ky fakt në deklaratën *Vetting*.

6.19 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.20 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashitroi: “Referuar ligjit nr. 84/2016, nenit 3, pika 11 të këtij ligji, parashikohet se: ‘Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit’. Sipas këtij ligji subjektet detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil; b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil...

*Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, deklaroj se gjatë periudhës së deklaramit nuk kam përdorur pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të personave të tjerë, pasi nuk kam fituar të drejtat reale me ndonjë kontratë noteriale sipas parashikimeve të Kodit Civil. Ndodhur në këto kushte, duke mos pasur ndonjë të drejtë reale mbi apartamentin në pronësi të shoqërisë ‘***’ në qytetin e Tiranës, nuk mund ta deklaroja në deklaratën e pasurisë *Vetting* si përdorim në rubrikën e deklaramit të ‘të drejtave reale të përdorimit apo banimit’ sipas Kodit Civil.*

*Duke qenë se shtetasi F.B, administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., që prej vitit 1995 ka pasur aktivitet të regjistruar për ndërtim pallatesh dhe unë kisha nevojë për strehim në kohën kur isha student në Shkollën e Magjistraturës. Në muajin nëntor 2012 ai më ofroi që të qëndroja në një apartament, i përbërë nga një dhomë e kuzhinë, e cila ndodhet në Tiranë, rr. ‘***’, ap. ***. Apartamenti më është lënë pa qira deri në muajin janar 2017, kohë në të cilën jam larguar për të jetuar së bashku me familjen në qytetin e Durrësit.*

*F.B, administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., për shkak të kësaj marrëdhënieje ka ardhur personalisht pranë zyrës së noteres, duke kërkuar redaktimin e dy deklaratave noteriale.*

*Pra, nga analizimi i këtyre dy deklaratave noteriale, provohet pretendimi im se nga muaji nëntor 2012 deri në janar 2017 kam jetuar pa paguar qira mujore në Tiranë, rr. ‘***’, pallati ‘****’, ap. ***, shk. ***. Për këtë apartament kam paguar rregullisht vetëm energjinë elektrike dhe çdo detyrim tjetër është paguar nga shoqëria.*

*Deklaroj se unë dhe personat e lidhur me mua (bashkëshortja e fëmijët) gjatë periudhës së deklaramit nuk ndodhemi në kushtet e një marrëdhënieje dhurimi apo huaje me ortakët apo administratorin e shoqërisë ‘***’, si dhe vetë këtë të fundit, për rrjedhojë nuk ndodhem në*

kushtet e një interesi pasuror, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në raport me pronarin e apartamentit, ku unë kam qëndruar gjatë periudhës së rivlerësimit e që janë deklaruar si adresa banimi nga ana ime.

Sikurse jam shprehur edhe më lart, marrëdhëniet ndërmjet meje dhe shtetasit F.B janë shoqërore, të cilat vazhdojnë të jenë të tilla edhe sot e kësaj dite. Në gjendjen që më është dhënë, apartamenti ka qenë bosh, i pamobiluar. Fillimisht është përshtatur për jetesë vetëm dhoma e ndenjjes dhe pas martesës kemi përshtatur edhe dhomën e gjumit. Arredimi në çdo rast ka qenë me mobilie të përdorura. Për këtë apartament kemi paguar rregullisht vetëm energjinë elektrike, ndërsa ujin nuk e kemi paguar pasi pallati furnizohej me ujë pusi.

*Sa i përket shlyerjes së detyrimeve ndaj të tretëve, sqaroj Komisionin se ato i kam shlyer, për aq sa më ka takuar dhe për të cilat kam qenë në dijeni. Administratori i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., shtetasi F.B, nëpërmjet deklaratave noteriale të depozituara si prova, ka pranuar se shtetasi Paulin Çera, gjatë gjithë kohës së banimit në këtë banesë, nuk ka paguar qira dhe detyrime të tjera, por ka paguar vetëm energjinë elektrike sipas konsumit mujor. Pallati ka qenë furnizuar me ujë pusi, ndërsa taksat dhe tarifat vendore janë paguar nga shoqëria.*

*Në çdo deklaram të bërë nga ana ime, adresa e banimit në Tiranë, rr. ‘***’, pallati ‘***’, ap. ****, është deklaruar rregullisht. Vetë pronari i këtij apartamenti në asnjë moment nuk ka pranuar që të më ketë dhuruar shuma në të holla, qoftë indirekt nëpërmjet përdorimit pa kundërshpërblim të pasurisë apartament për gati 5 vjet. Apartamenti është pranuar nga ana ime pa kundërshpërblim dhe pronari i saj nuk ka pasur asnjë lloj pretendimi deri në momentin e largimit tim. Bëhet fjalë për një apartament prej 56 m², të pamobiluar, në një zonë të largët në raport me vendndodhjen e Shkollës së Magjistraturës apo me qendrën time të punës, me kushte minimale për jetesë, përfshirë edhe kohën kur më kanë lindur fëmijët e deri sa jam larguar. Nuk do të pranoja në asnjë rrethanë që për këtë apartament të paguaja qira, aq më tepër vlerën 20,000 lekë”.*

Vlerësimi i Komisionit

6.21 Trupi gjykues vlerëson se detyrimi për deklarimin e pasurisë në përdorim nuk rrjedh nga dispozitat e Kodit Civil lidhur me të drejtat reale, por nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016. Pika 11 e nenit 3 të këtij ligji përcakton se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj... që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*. Gjithashtu, edhe pika 4 e nenit 32 përcakton se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”*.

6.22 Subjekti ka pasur një marrëdhënie juridike me palën huadhënëse të apartamentit, e cila ka qenë pa kundërshpërblim. Në këtë marrëdhënie kanë lindur të drejta dhe detyrime për palët, si dhe konsiderohet si një marrëdhënie interesi midis tyre. Subjekti e ka disponuar dhe përdorur sipas deklaramit të tij qetësisht këtë pasuri gjatë gjithë periudhës gati 5-vjeçare, duke shlyer edhe detyrime ndaj të tretëve për këtë pasuri.

6.23 Trupi gjykues, në vlerësimin përfundimtar, arriti në përfundimin se subjekti duhej dhe e kishte detyrim ligjor për deklarimin e përdorimit të apartamentit përgjatë viteve 2012 – 2017 në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*. Koncepti i qëndrimit në banesë me atë të përdorjes së kësaj banese nuk përbën ndryshim, në kuptimin e përcaktimit nga neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, çka do të thotë se subjekti ka pasur detyrimin për deklarim jo vetëm të pasurive në pronësi dhe posedim, por edhe atyre në përdorim. Aq më tepër që me pronarin e këtij apartamenti të dhënë në përdorim subjekti nuk kishte marrëdhënie familjare apo të afërm,

që të mund ta përdorte atë pa kundërshtim, pavarësisht kontributit të dhënë apo jo për krijimin e kësaj pasurie.

6.24 Por, trupi gjykues vlerësoi se ky mosdeklarim nga ana e subjektit nuk përbën shkak dhe nuk shihet si rrethanë që çon në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.

6.25 Mosdeklarimi i pasurisë në përdorim duket që nuk është bërë me qëllim fshehjen e këtij fakti apo të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti si adresë vendqëndrimi në deklaratat periodike vjetore dhe atë *Vetting* (në rubrikën e adresave sipas viteve përkatëse).

6.26 Nuk u konstatua që subjekti i rivlerësimit të këtë qenë në konflikt interesi me shoqërinë “****” sh.p.k., ortakët apo administratorin e saj, pasi nuk rezultoi të këtë gjykuar ndonjë çështje gjyqësore me këto subjekte gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar.

6.27 Apartamenti që subjekti ka pasur në përdorim është ndërtuar me lejen e ndërtimit të vitit 2005 nga shoqëria “****” sh.p.k., dhe sipas aktkolaudimit provohet përfundimi i këtij pallati në datën 25.8.2008. Gjithashtu, për këtë apartament është lidhur kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 27.4.2017, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse M.Gj, në vlerën 27,500 euro.

6.28 Në analizë të këtyre fakteve, trupi gjykues rrëzon çdo dyshim të mundshëm që pasuria apartament të këtë qenë pasuri e fshehur e subjektit apo që subjekti të këtë pasur ndonjë interes pasuror mbi këtë pasuri.

7. Dhurim nga babai i subjektit në vitin 2015

7.1 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar të ardhura në formë dhurimi nga babai N.Ç në shumën 279,000 lekë në vitin 2015.

7.2 Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar këto të ardhura apo dhurim nga babai.

7.3 Edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 subjekti nuk ka deklaruar në rubrikën përkatëse të formularit të deklarimit këtë dhurim.

7.4 Për këtë dhurim dhe mosdeklarimin e saj në DPV/2015, u pyet subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit¹⁵ deklaroi: *“Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, në faqen 3 të saj, konkretisht në rubrikën e pasurive, kam deklaruar: ‘Llogari bankare ‘Raiffeisen Bank’, nr. ***-ALL. Gjendja nga data 1.1.2015 – 31.12.2015. Burimi i krijimit: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të ardhurat nga familja’. Ndërsa në rubrikën ‘Vlera me shifra dhe fjalë’ kam deklaruar: ‘1,292,238 lekë. Nga këto 996,754 lekë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pjesa tjetër të ardhura nga familja’. Në datën 22.4.2015 në llogarinë time bankare babai im N.Ç ka depozituar shumën 279,000 lekë (bashkëlidhur llogaria rrjedhëse e datës 14.7.2022 në emrin tim). Nëse do të zbresim të ardhurat nga paga del qartësisht shumë e dhënë dhuratë nga prindërit që gjendet në llogarinë bankare. Pra, unë e kam deklaruar shumën e dhënë dhuratë nga prindërit në deklaratën e pasurisë të vitit 2015.*

Për të provuar burimin e krijimit të shumës së dhënë dhuratë prej 279,000 lekësh, po ju paraqes në cilësinë e provave shkresore disa akte”.

7.5 Komisioni konstatoi se në DPV/2015 subjekti ka deklaruar në rubrikën e pasurive: *“Llogari bankare pranë ‘Raiffeisen Bank’ me gjendje nga data 1.1.2015 - 31.12.2015 me vlerë 1,292,238 lekë. Nga këto 996,754 lekë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pjesa tjetër të ardhura nga familja”.*

7.6 Komisioni analizoi mundësinë financiare të babait të subjektit për t’i dhuruar vlerën 279,000 lekë në vitin 2015, bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 11.7.2017, lëshuar nga

¹⁵Shini përgjigjen e subjektit mbi pyetësorin nr. *** në dosjen e Komisionit.

ISSH-ja për shtetasin N.R.Ç, me të cilin provohen të ardhurat e babait të subjektit nga viti 2012 e në vazhdim¹⁶.

Analiza e mundësisë së dhurimit të vlerës 279,000 lekë nga z. N.Ç, datë 22.4.2015

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga pagat N.Ç, 2012 – 22.4.2015	1,328,134
Shpenzime jetese 2012 – 22.4.2015	575,329
Dhurim subjektit datë 22.4.2015	279,000
Mundësia e dhurimit	473,805

7.7 Bazuar në analizën financiare rezultoi se babai i subjektit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e vlerës 279,000 lekë djalit të tij, si dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

Konkluzion i Komisionit

7.8 Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë dhurim (as si të ardhur) nga babai në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe nuk e ka deklaruar as në DPV/2015 dhurimin në rubrikën përkatëse të formularit të pasurisë.

Për këtë konstatim të Komisionit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi: *“Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, në faqen *** të saj, konkretisht në rubrikën ‘Ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit’ kam deklaruar: ‘Llogari bankare ‘Raiffeisen Bank’, nr. ***- ALL. Gjendja nga data 1.1.2015 - 31.12.2015. Burimi i krijimit: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të ardhurat nga familja’. Ndërsa në rubrikën ‘Vlera me shifra dhe fjalë’ kam deklaruar: ‘1,292,238 lekë. Nga këto 996,754 lekë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pjesa tjetër të ardhura nga familja’. Në datën 22.4.2015 në llogarinë time bankare babai im N. Ç ka depozituar shumën 279,000 lekë. Nëse do të zbresim të ardhurat nga paga del qartësisht shumë e dhënë dhuratë nga prindërit që gjendet në llogarinë bankare. Pra, unë e kam deklaruar shumën e dhënë dhuratë nga prindërit në deklaratën e pasurisë të vitit 2015. Për nga mënyra se si kam proceduar, ashtu si me të drejtë Komisioni ka konstatuar, është e dukshme se një deklaram i tillë ka ardhur si rezultat i moskuptimit tim në lidhje me plotësimin e deklaratës periodike apo atë *Vetting*. Gjithsesi, bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni kundrejt babait tim N. Ç, është konkluduar se ai ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e vlerës 279,000 lekë, si dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës”.*

Vlerësimi i Komisionit

7.10 Trupi gjykues arriti në përfundimin se, pavarësisht mosdeklarimit në mënyrë të saktë në rubrikën e posaçme të këtij dhurimi nga babai i tij, subjekti nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij dhurimi (ose e kësaj të ardhure) për vitin përkatës.

Kështu që subjekti konsiderohet të ketë bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me krijimin e kësaj “të ardhure” që vjen nga dhurimi nga babai i tij dhe provoi mundësitë financiare të ligjshme për këtë dhurim.

¹⁶Shihni praktiken në dosjen e ILDKPKI-së.

8. Deklarimi i kursimeve cash

8.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* jashtë sistemit bankar.

8.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 125,000 lekë, me burim të ardhura nga puna dhe Shkolla e Magjistraturës. Bashkëshortja e subjektit, po në këtë deklaratë, ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 400,000 lekë, si dhurim nga prindërit e saj.

8.3 Në deklaratën periodike për vitin 2014 subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*, kurse bashkëshortja ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 300,000 lekë.

8.4 Në DPV-të në vijim për vitet 2015 - 2016 subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash* (shtesa apo pakësime).

8.5 Lidhur me mosrakordimin e deklaramit të gjendjes *cash* sipas DPV-ve dhe deklaratës *Vetting* është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar se: “Në DPV-të e viteve 2014, 2015 dhe 2016 shumën 125,000 lekë nuk e kam deklaruar, pasi e kam pasur të konsumuar në datën 31.12.2014 për nevoja familjare.

Gjithashtu, në DPV/2014 bashkëshortja ime ka deklaruar 300,000 lekë. Për periudhën 25.11.2014 - 31.12.2014 nga shuma 400,000 lekë që ka pasur gjendje në datën 25.11.2014 ka shpenzuar vlerën 100,000 lekë, duke pasur gjendje cash në datën 31.12.2014 vlerën 300,000 lekë. Ndërkohë në DPV-të 2015 dhe 2016 shumën 300,000 lekë, bashkëshortja ime nuk e ka deklaruar, pasi e kemi shpenzuar brenda vitit 2015 për nevoja familjare”.

8.6 Përgjigjet e subjektit lidhur me gjendjen *cash* duket se nuk janë të sakta në përputhje edhe me DPV-të e viteve 2014 – 2016. Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar, duke përfshirë ndryshimet (shtesa dhe pakësimet për çdo vit).

8.7 Komisioni në analizë financiare ka përshtirë gjendjen *cash* sipas deklarameve të subjektit në deklaratat periodike vjetore.

Konkluzion i Komisionit

8.8 Në përfundim të hetimit Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore, të cilat nuk përputhen me deklaratën *Vetting* dhe për këtë konstatim iu kërkua të jepte shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi: “Në këtë rast provohet mundësia financiare për burimin e gjendjes *cash* në deklaratat periodike po që nuk ekziston ditën e dorëzimit të deklaramës *Vetting*. Gjithashtu, dua të theksoj se gjendja *cash* nuk na ka shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie, por ka shërbyer për shpenzime familjare”. Ndërsa në lidhje me mundësinë e krijimit të shumës 400,000 lekë *cash*, të deklaruar nga bashkëshortja, subjekti shpjegon se: “...bashkëshortes sime i është dhuruar shuma prej 400,000 lekësh nga prindërit e saj, për faktin se në vitin 2013 ajo nuk bëri ceremoni martese. Këto fakte janë provuar para Komisionit, nëpërmjet provave të dërguara së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. ***”.

Vlerësimi i Komisionit

8.10 Trupi gjykues, pas shpjegimeve të subjektit konsideroi se pasaktësia në drejtim të deklaramit të plotë, që lidhet me deklarimin e ndryshimit të gjendjes *cash* (shtesa apo pakësime) në deklaratat periodike, veçanërisht kur kjo pasaktësi nuk shoqërohet me pamundësi krijimi të kësaj gjendjeje *cash*, nuk e ngarkon subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi në procesin e

rivlerësimit. Prandaj, trupi gjykues i konsideroi shpjegimet e subjektit si të mjaftueshme për këtë çështje.

9. Analiza financiare

9.1 Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin dhe personat e lidhur si vijon:

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: PAULIN N. ÇERA - 30.10.14 - 2016				
PERSHKRIMI	30.10.14 - 31.12.14	2015	2016	TOTAL
PASURI	-102,462	-233,194	-4,589	-340,244
Autoveturë Ford Focus **** - 2014 - 100% - 1,400€				0
Ndryshim ne likuiditet	-102,462	-233,194	-4,589	-340,244
DETYRIME	-14,750	-95,448	-109,129	-219,327
Kredi Societe Generale Albania - 500,000 leke - 2013	-14,750	-95,448	-109,129	-219,327
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	-87,712	-137,745	104,541	-120,917
TE ARDHURA TE DOKUMENTUARA	241,026	1,696,610	1,374,158	3,311,794
Të ardhura nga puna subjekti Paulin Cera	192,164	996,754	1,047,575	2,236,493
Të ardhura nga puna bashkëshortja B. Ç.	48,862	420,856	326,583	796,301
Të ardhura nga dhurimi nga prindërit e subjektit - 2015		279,000		279,000
SHPENZIME	166,054	765,922	965,930	1,897,907
Shpenzime jetese	109,999	710,207	940,368	1,760,574
Shpenzime interes kredi Societe General - 500,000 lekë	56,055	41,057	25,562	122,674
Shpenzime udhëtimi		14,658		14,658
Analiza dokumentuar	162,684	1,068,433	303,687	1,534,804
		Pamundesi financiare		0

9.2 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij kishin burime të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve për periudhën e rivlerësimit.

9.3 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Kjo analizë financiare mund të jetë objekt ndryshimi në varësi të provave dhe shpjegimeve të subjektit për këto rezultate hetimi, si dhe vlerësimi përfundimtar nga Komisioni.

Gjatë kësaj analize Komisioni është bazuar në:

- Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: BKT-ja, “Raiffeisen Bank”, “Credins Bank”, “Societe Generale Albania”, “Alpha Bank”, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.
- Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:
 - të ardhurat nga pagat e subjektit në Drejtorinë e Policisë Dibër (në vitet 2010 – 2012), Shkollën e Magjistraturës (në vitet 2012 – 2014), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (në vitet 2014 – 2016), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (viti 2016), nga mësimdhënia në universitetin “***”, Durrës (në vitet 2013 – 2014);
 - të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit në Drejtorinë Arsimore Dibër (për vitet 2013 – 2016) dhe nga raportet e barrëlindjes (për vitet 2014 – 2016);
 - të ardhurat nga dhurimi i babait të subjektit N.Ç (viti 2015);
 - të ardhura nga pasuri paramartesore e bashkëshortes (viti 2013).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i) shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i), për periudhën 2010 – 30.10.2014 shpenzimet e jetesës janë llogaritur për subjektin gjatë gjithë periudhës, për bashkëshorten që nga data e martesës dhe për fëmijët që nga data e lindjes e në vazhdim;
- ii) shpenzime interesi dhe komisione, si dhe shlyerje principali për kreditë e marra nga subjekti në “Raiffeisen Bank” dhe “Societe Generale Albania”, sipas vërtetimeve dhe *statementit* bankar përkatës;
- iii) shpenzime për blerje fidanësh nga subjekti (viti 2010) sipas deklarimit të bërë prej tij në përgjigje pyetëso;
- iv) shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019(JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

ç. Vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁷.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

10. Trupi gjykues, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Paulin Çera me anë të verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

2. Në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, DSIK-ja, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe neneve 37 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. *** prot., datë 31.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Paulin Çera, ku ka konstatuar se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat të mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të kimit të organizuar.
- Subjekti i rivlerësimit Paulin Çera është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

¹⁷Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

Për pastërtinë e figurës nuk ka pasur të dhëna dhe dyshime bazuar në raportin e DSIK-së.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2022, DSIK-së iu kërkua përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit Paulin Çera.

4. Në datën 27.9.2022 është paraqitur raporti i deklasifikuar pjesërisht i DSIK-së (nr. *** vendimi, datë 19.9.2022), ku konstatohet se për subjektin Paulin Çera disponohen të dhëna mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës dhe veprimit korruptiv.

5. Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, DSIK-ja konstaton se:

- *Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmërinë në vijim të ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Paulin N Çera, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj këtij subjekti.*

Bazuar në faktet e sipërpërmendura, pas hetimit nga Komisioni, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjektit i rivlerësimit e ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje-daljet jashtë vendit sipas informacionit nga sistemi TIMS.

Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Paulin Çera ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Ky raport është përgatitur për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për subjektin e rivlerësimit Paulin Çera, aktualisht në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është hartuar ky raport duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit;
- pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

3. Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa kundërthënie dhe sipas shtojcës që parashikon ligji.

4. Konstatohet se z. Paulin Çera ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, duke marrë titullin “Jurist” pranë universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në datën 20.7.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

5. Subjekti Paulin Çera nga tetori i vitit 2012 deri në tetor të vitit 2014 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Me Dekretin Nr. 8768, datë 31.10.2014, të Presidentit të Republikës, është caktuar përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa me Dekretin Nr. 9657, datë 23.6.2016, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

6. Sipas deklarimeve të subjektit dhe tabelave statistikore, rezultojnë 413 çështje të caktuara gjithsej, ndërsa ka përfunduar si relator 372 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në atë të Rrethit Gjyqësor Durrës. Lidhur me çështjet e mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës, gjyqtari Paulin Çera rezulton me 79 çështje të mbartura në vitin 2017.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1 – vendimi civil nr. ***, datë 23.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit F.K, me të paditur I.N.T, me objekt “pagimi i dëmshpërblimit për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, me 12 paga mujore, etj.”.

Nuk pasqyrohen të dhëna në vendim nëse kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse. Rezulton se vendimi nuk përmban nënshkrimin e sekretares gjyqësore dhe as vulën e gjykatës.

Nga analiza e përmbajtjes së vendimit rezulton se shqyrtimi i çështjes është zhvilluar në seancë gjyqësore nga gjyqtari Paulin Çera i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në praninë e palëve ndërgjyqëse. Seanca e fundit, ku është shpallur edhe vendimi, është zhvilluar në datën 23.3.2015, por lidhur me afatin e këtij gjykimi nuk pasqyrohen të dhëna. Në këto rrethana, nuk mund të konkludohet nëse kjo çështje është shqyrtuar brenda apo jashtë afatit standard 6-mujor të gjykimit, të përcaktuar nga germa “e” e pikës 5 të vendimit të KLD-së, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Teksti i vendimit paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 16 faqe, por vendimi nuk përmban në fund të tij nënshkrim të sekretares gjyqësore dhe as vulë të gjykatës.

Gjyqtari nuk ka përdorur në arsyetim ndonjë parim të së drejtës.

Dokumenti 2 – vendimi civil nr. ***, datë 30.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit të kundërpaditur P. S, me të paditur B. C, me të paditur kundërpaditëse F.C, me objekt të padisë “detyrimi i të paditurve të njohin paditësin P. Sh pronar të sipërfaqes ndërtimore prej 255 m² të një ndërtese...”, me objekt të kundërpadisë “konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së premtim shitjes nr. ***, datë 13.10.2011. Rikthimin e palëve në gjendjen e mëparshme”.

Nuk pasqyrohen të dhëna në vendim, nëse kundër tij është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse. Konstatohet se vendimi nuk përmban nënshkrimin e sekretares gjyqësore dhe as vulën e gjykatës.

Gjyqtari nuk ka përdorur në arsyetim ndonjë parim të së drejtës apo jurisprudencë të gjykatave të huaja.

Dokumenti 3 – vendimi penal nr. ***, datë 5.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që i përket të pandehurit P. V, i akuzuar për veprën penale “vjedhje me dhunë”, të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal.

Nuk pasqyrohen të dhëna në vendim, nëse kundër tij është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse. Konstatohet se vendimi nuk përmban nënshkrimin e dy gjyqtarëve të tjerë të trupit gjykues, as të sekretares gjyqësore dhe as vulën e gjykatës.

Lidhur me konstatimet e bëra nga Komisioni mbi 3 çështjet e paraqitura, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja civile me nr. *** regj., datë 25.2.2015, me palë paditëse F. K., i paditur I.N.T, me objekt ‘detyrimin e palës së paditur për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës të më paguajë një dëmshpërblim prej 12 pagash mujore, ...’.* Rezulton se kjo çështje ka ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 16.2.2015, ka vendosur: *‘1. Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë... 2. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente në lëndë për shqyrtimin e saj. Kundër këtij vendimi mund të behët ankim së bashku me vendimin përfundimtar’.*

Në datën 25.2.2015, kjo çështje më është caktuar për shqyrtim. Sipas fletës së regjistrimit, rezulton se për këtë çështje janë zhvilluar 4 seanca. Me vendimin nr. ***, datë 25.3.2015 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *‘Pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar të paditurin që t’i paguajë paditësit 8 paga mujore për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me efekt të menjëhershëm pa shkaqe të justifikuara...’.* Në këtë vendim janë evidentuar shpenzimet gjyqësore, përcaktuar e drejta e ankimit, si dhe është lëshuar urdhërezekutimi, pasi kishim të bënim me padi detyrimi. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 14.7.2016, ka vendosur: *‘Lënien në fuqi të vendimit civil nr. ***, datë 25.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë’.* Sipas shënimeve të vendosura nga kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi i arsyetuar është depozituar nga ana ime në datën 8.4.2015. Pra, rezulton se kjo çështje është shqyrtuar nga ana ime brenda afatit 6-mujor, duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Vendimi i arsyetuar është depozituar në kryesekretari brenda 10 ditëve punë, sipas parashikimeve të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile. Bashkëlidhur do të gjeni¹⁸:

Së dyti, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja civile me nr. *** regj., datë 18.12.2014, me palë paditëse P. Sh., të paditur B. Ç. dhe F. Ç., me objekt ‘njohje pronar’. Në seancën e datës 3.4.2015, paditësi ka paraqitur një kërkesë për saktësimin e objektit të padisë duke kërkuar përfundimisht: *‘Detyrimin e të paditurve F. Ç. dhe B. Ç. të njohin paditësin P. Sh. pronar të një sip. ndërtimore prej 255 m², gjithë katin e gjashtë të një ndërtese të ndodhur në z. k. ***, me nr. *** pasurie’.* Gjykata duke çmuar se është e drejta e paditësit të disponojë mbi objektin e padisë, por pa ndryshuar shkakun ligjor të saj, në bazë të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur të pranojë kërkesën, duke vazhduar gjykimin me objektin e pakësuar të padisë. Në të njëjtin proces pala e paditur-kundërpaditëse znj. F. Ç. ka paraqitur

¹⁸Kopje të njëzuar me origjinalin të vendimit nr. ***, datë 25.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe fletë regjistrimi “numërori i vendimeve civile në gjykatën e shkallës së parë”.

kundërpadi, ku ka kërkuar 'konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës premtim shitjeje nr. ***, datë 13.10.2011. Rikthimin e palëve në gjendjen e mëparshme'. Me kërkesë të palës paditëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (me tjetër trup gjykues) me vendimin nr. *** akti, datë 2.3.2015 ka vendosur: 'Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë deri në përfundim të këtij gjykimi...'. Gjatë gjykimit rezultoi se kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim, por është ekzekutuar nga ZVRPP-ja Tiranë.

Kjo çështje më është caktuar për shqyrtim në datën 18.12.2014. Për këtë çështje janë zhvilluar 7 seanca dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 30.4.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: '1. Rrëzimin e padisë. 2. Heqjen e masës së sigurimit të padisë së marrë me vendimin nr. *** akti, datë 2.3.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e garancisë prej 2,000 euro paditësit të depozituar në BKT. 3. Rrëzimin e kundërpadisë. 4. Shpenzimet gjyqësore u ngarkohen palëve në përpjesëtim me pjesën e rrëzuar të padisë dhe kundërpadisë. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së tij'. Sipas fletës së regjistrit të kryesekretarisë, vendimi i arsyetuar është depozituar në datën 8.5.2015. Pra, rezultoi se kjo çështje është shqyrtuar nga ana ime brenda afatit 6-mujor, duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Vendimi i arsyetuar është depozituar në kryesekretari, sipas parashikimeve të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Sipas shënimeve të vendosura në këtë vendim, rezultoi se ndaj tij është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 1.3.2017, ka vendosur: 'Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 30.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt: Pranimin e padisë. Detyrimin e palës së paditur k/paditëse B.Ç dhe F.Ç për të njohur pronar paditësin e k/paditur P.Sh, mbi një banesë me sipërfaqe 255 m², në katin e gjathtë të një pallati të ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. pasurie ***, si dhe detyrimin e ZVRPP-së Tiranë të regjistrojë këtë banesë në emrin e paditësit P.Sh. Rrëzimin e kundërpadisë si të pabazuar në ligj e në prova'. Pra, duket sikur vendimi i shkallës së parë është ndryshuar pjesërisht vetëm sa i përket pretendimeve të palës paditëse, ndërsa është vendosur rrëzimi i kundërpadisë, ashtu sikurse kishte vendosur shkalla e parë. Kundër këtij vendimi rezultoi të jetë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja është në pritje të shqyrtimit. Bashkëlidhur do të gjeni¹⁹:

Së treti, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës rezultoi se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja penale nr. *** regj., datë 28.7.2016, me palë kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me të pandehur (të miturin) P. V., i akuzuar për kryerjen e veprës penale 'vjedhje me dhunë', parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Në datën 28.7.2016 është marrë vendimi për caktimin e seancës për gjykimin e kësaj çështjeje penale. Çështja është kryesuar nga unë si gjyqtar relator, me përbërjen e dy gjyqtarëve të tjerë, nisur nga fakti se vepra duhej të shqyrtohej me trup gjykues. Për këtë çështje janë zhvilluar dy seanca gjyqësore (20.9.2016 dhe 5.10.2016). Me vendimin nr. ***, datë 5.10.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: '1. Deklarimin fajtor të të pandehurit P. E. V. për kryerjen e veprës penale 'vjedhje', parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 6 muaj burgim... 6. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimit paraprak në masën 1,000 lekë, si dhe ato gjyqësore në ngarkim të të pandehurit. 7. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, brenda 10 ditëve, duke filluar të përlllogaritet ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi'.

¹⁹Kopje të njësuar me origjinalin të vendimit nr. ***, datë 30.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, së bashku me shënimin mbi vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe fletë regjistri "numërori i vendimeve civile në gjykatën e shkallës së parë".

Sipas shënimeve të vendosura nga kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendimi i arsyetuar është depozituar nga ana ime në datën 17.10.2016. Pra, rezulton se kjo çështje është shqyrtuar nga ana ime brenda afatit ligjor, duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Vendimi i arsyetuar është depozituar në kryesekretari brenda 8 ditëve punë, sipas parashikimeve të nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim rezulton se ka marrë formë të prerë në datën 17.10.2016, pasi nuk është ankimuar nga palët”.

Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja 1 – çështja penale nr. *** regj., datë 23.2.2015, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të pandehurit F. A, i akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, e parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ****, datë 9.4.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 23.2.2015 dhe sipas shënimit në dosje të kryetarit të gjykatës, në shortin e datës 24.2.2015, çështja i është caktuar gjyqtarit Paulin Çera. Me vendimin e datës 27.2.2015, gjyqtari Paulin Çera ka vendosur kalimin e çështjes në seancën gjyqësore të datës 10.3.2015, ora 12:00, duke urdhëruar sekretarinë gjyqësore të njoftojë palët ndërgjyqëse.

Janë zhvilluar gjithsej 5 seanca gjyqësore. Në përfundim, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit F. A për veprën penale ‘vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike’, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal dhe dënimit e tij me 3 muaj burgim.*

Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale ulet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri F. A me 2 muaj burgim.

Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim, duke e vënë në provë të pandehurin F. A për një periudhë kohe prej 18 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale...”.

Rezulton nga aktet në dosje se vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar në kryesekretari nga gjyqtari Paulin Çera në datën 17.4.2015 – pas 8 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar. Vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda 10 ditëve, parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale. Seancat vijuese janë caktuar në afate të arsyeshme dhe duke respektuar afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale. Janë caktuar 5 seanca gjyqësore, nga të cilat 3 kanë qenë produktive. Pengesë në dy seancat joproduktive ka qenë mosparaqitja e të pandehurit (shihni seancën 1) dhe mosparaqitja e prokurorit (shihni seancën 4). Në fillimin e 5 seancave gjyqësore nuk ka pasur vonesë, por asnjëra prej tyre nuk është dokumentuar me regjistrim audio, jashtë funksionit të transparencës dhe të solemnitetit ne gjykim.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndërtuar me paragrafë të evidentuar dhe të numërtuar, sipas analizës së provave dhe elementeve të figurës së veprës penale. Në arsyetim vërehet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 14 faqe gjithsej.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, vendimi nr. ***, datë 11.1.2006, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 24, datë 30.4.2012, i Gjykatës Kushtetuese, vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. ***, datë 12.6.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, udhëzimi nr. ***, datë 14.3.1979, i Plenumit të Gjykatës së Lartë dhe vendime të GJEDNJ-së. Gjyqtari ka përdorur shprehimisht parimin e të drejtës së “prezumimit të pafajësisë”.

Dojsa 2 – çështja civile nr. *** regj., datë 18.12.2014, që i përket paditëses E. L, me të paditur “T.U.T” sh.a., me objekt “detyrim për pagimin e dëmshpërblimeve për zgjidhjen e kontratës së punës”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.2.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 18.12.2014 dhe sipas shënimit në dosje të kryetarit të gjykatës, në shortin e datës 19.12.2014, i është caktuar për gjykim gjyqtarit Paulin Çera. Rezulton nga aktet në dosje se me vendimin e datës 23.12.2014, gjyqtari Paulin Çera ka caktuar seancën përgatitore më 19.1.2015, ora 11:00, duke urdhëruar njëkohësisht njoftimin e palëve ndërgjyqëse.

Janë zhvilluar gjithsej 6 seanca gjyqësore. Në përfundim, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e palës së paditur shoqëria ‘T.U.T’ sh.a. të dëmshpërblejë paditësen E. L me 6 paga mujore për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me efekt të menjëhershëm pa shkaqe të justifikuar. Detyrimin e palës së paditur shoqëria ‘T.U.T’ sh.a. të dëmshpërblejë paditësen E. L me 2 paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës”.*

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 17.11.2015, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes. Janë caktuar gjithsej 7 seanca (1 seancë përgatitore dhe 6 seanca gjyqësore), nga të cilat 5 seanca kanë qenë produktive. Pengesë për 2 seancat joproduktive është bërë mosparaqitja e palës së paditur (shihni seancat 2 dhe 3). Seancat janë caktuar me distancë rreth 10 ditë nga njëra-tjetra dhe seanca e fundit për shpallje të vendimit është caktuar brenda afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile. Konstatohet se asnjëra nga seancat nuk është dokumentuar me regjistrim audio dhe asnjëra prej tyre nuk ka filluar me vonesë, por mosdokumentimi i tyre me regjistrim audio është jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë e baza ligjore, si dhe kërkesat përfundimtare të palëve ndërgjyqëse. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në pjesën e fundit të vendimit gjendet dispozitivi, i cili është i shkruar qartë.

Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndërtuar me paragrafë dhe tituj të evidentuar e të numërtuar, sipas analizës së çështjes. Rregullat e drejtshkrimit janë respektuar tërësisht dhe

janë përdorur gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë e i kuptueshëm, në 15 faqe gjithsej.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit të Punës, Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 49/2012, vendimi unifikues nr. 19, datë 15.11.2007, i Gjykatës së Lartë, vendimi nr. ***, datë 13.3.2008, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimi nr. ***, datë 8.6.2006, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimi unifikues nr. 19, datë 15.11.2007, i Gjykatës së Lartë, etj. Gjyqtari nuk ka përdorur shprehimisht në arsyetim ndonjë parim të përgjithshëm të së drejtës, por një standard të lartë në shkrimin e këtij vendimi.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regj., datë 17.3.2015, që i përket palës kërkuese shoqëria përmbartimore gjyqësore private “****” sh.p.k., me objekt “emërimi i përfaqësuesit për debitorët R. N dhe E. N”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.3.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.3.2015 dhe sipas shënimit në dosje të kryetarit të gjykatës, me shortin e datës 18.3.2015, i është caktuar për gjykim gjyqtarit Paulin Çera. Sipas njoftimeve të administruara në dosje të datës 20.3.2015, gjyqtari Paulin Çera ka caktuar seancën gjyqësore më 25.3.2015, ora 11:30.

Janë zhvilluar gjithsej 3 seanca gjyqësore. Në përfundim, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur: *“Pranimin e kërkesës. Caktimin si përfaqësues ligjor për debitorin R. K. N, E. V. N, R. N. PF, avokaten A.Z me nr... licence..., për të përfaqësuar ligjërisht këta debitorë në procedurat e ekzekutimit të titujve ekzekutivë kontratë kredie...”*.

Rezulton nga aktet në dosje se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ushtruar ankim kundër tij.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes. Janë caktuar gjithsej 2 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë produktive. Seancat janë caktuar me distancë 2 ditë nga njëra-tjetra. Në të dyja seancat gjyqësore është dokumentuar orari i fillimit dhe asnjëra nuk ka filluar me vonesë, por nuk janë dokumentuar me regjistrim audio, jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në procesverbalet e seancave në formatin letër evidentohet në mënyrë të drejtpërdrejtë mënyra e komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndërtuar me paragrafë të numërtuar, sipas analizës së kërkimit të kërkesës. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm, në 5 faqe gjithsej.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. ***, datë 11.1.2006, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr. 23, datë 17.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese. Gjyqtari ka përdorur shprehimisht në vendim parimin e legjitimitetit *locus standi* për paraqitjen e kërkesës.

Dosja 4 – çështja civile me nr. *** regj., datë 11.2.2015, që i përket paditësit V. K, me të paditur M. K, me objekt “zgjidhje martesë”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 12.3.2015.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 11.2.2015 dhe sipas shënimit në dosje të kryetarit të gjykatës, në shortin e datës 12.2.2015 i është caktuar për gjykim gjyqtarit Paulin Çera. Rezulton nga aktet në dosje se me vendimin e datës 16.2.2015, gjyqtari Paulin Çera ka caktuar seancën e pajtimit më 27.2.2015, ora 10:30. Janë zhvilluar gjithsej 2 seanca gjyqësore. Në përfundim, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur: “Pranimin e padisë; zgjidhjen e martesës midis paditësit V. K. dhe të paditurës M. K.”.

Rezulton nga aktet në dosje se nuk është ushtruar ankim kundër këtij vendimi.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për zgjidhjen brenda afatit të mosmarrëveshjes. Janë caktuar gjithsej 2 seanca (1 seancë përgatitore pajtimi dhe 1 seancë gjyqësore), të cilat kanë qenë produktive. Seancat janë caktuar me distancë rreth 15 ditë nga njëra-tjetra. Në të dyja seancat gjyqësore është dokumentuar orari i fillimit, por nuk janë dokumentuar ato me regjistrim audio, siç përcaktohet në udhëzimin nr. 353, datë 3.9.2013, të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për marrjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio” dhe jo në funksion të transparencës dhe solemnitetit në gjykim.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga neni 310 i Kodit të Procedurës Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën e hyrëse janë përshkruar palët ndërgjyqëse, objekti i padisë e baza ligjore, si dhe pretendimet përfundimtare të palëve. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në përfundim të shqyrtimit gjykata ka mbërritur në përfundimin se bashkëjetesa mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston dhe martesë e tyre e ka humbur qëllimin e saj, ajo ka mbetur prej kohësh formale, prandaj në këto kushte duhet të zgjidhet. Në pjesën e fundit të vendimit gjendet dispozitivi, i cili është i shkruar qartë.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit të Familjes dhe Kodit të Procedurës Civile. Gjyqtari ka përdorur shprehimisht në vendim parimin e legjitimitetit *locus standi* për ngritjen e padisë.

Dosja 5 – çështja administrativo-penale me nr. *** regj., datë 15.6.2015, që i përket kërkuesit I. Shehi, me objekt “shuarja/revokimi i masës së sigurimit ‘arrest në burg me afat 60-ditor’”, parashikuar në nenin 261/ç të Kodit të Procedurës Penale, e përfunduar me vendimin datë 17.6.2015.

Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 15.6.2015 dhe po atë ditë, meqenëse masa e sigurimit ishte caktuar nga gjyqtarja R. B, i është caktuar kësaj gjyqtareje. Por, sipas shënimit në dosje të kryetarit të gjykatës, kjo gjyqtare ishte me raport mjekësor, ndaj sipas grafikut, i ka kaluar për gjykim subjektit të rivlerësimit Paulin Çera. Sipas njoftimeve të administruara në dosje, të datës 16.6.2015, gjyqtari Paulin Çera ka caktuar seancën gjyqësore në datën 17.6.2015, ora 13:00.

Është zhvilluar 1 seancë gjyqësore, ajo e datës 17.6.2015, e çelur në orën 13:40, me 40 minuta vonesë të paretuar shkakun dhe është dokumentuar me procesverbal, pa regjistrim audio. Në përmbajtje të procesverbalit evidentohet se është paraqitur kërkuesi me avokatin e zgjedhur prej tij dhe përfaqësuesi i Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

Në përfundim, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur: “*Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit I. Sh për shuarjen e masës shtrënguese të përkohshme ‘arrest në burg me afat 60-ditor’ ndaj shtetasit I. Sh, dhënë me vendimin nr. *** akti, datë 16.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*”.

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi, por Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 7.7.2015, ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. *** akti, datë 17.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Gjyqtari ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, brenda afatit ligjor. Vendimi për caktimin e seancës gjyqësore është marrë menjëherë me depozitimin e kërkesës së kërkuesit. Në fillimin e seancës gjyqësore ka pasur 40 minuta vonesë të paretuar shkakun dhe seanca është dokumentuar pa regjistrim audio, jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Në pjesën hyrëse është përshkruar kërkuesi me objektin e kërkesës, dispozita ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të kërkuesit dhe të prokurorit. Pjesa arsyetuese është e ndarë në dy nënpjesë. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata ka mbërritur në përfundimin se kërkesa e kërkuesit gjendet e papabuar.

Nga pikëpamja e strukturës, vendimi është i ndërtuar me paragrafë të evidentuar, sipas analizës së kërkimit.

Përmenden dhe analizohen në arsyetim norma të Kushtetutës, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe Traktati për Ekstradimet me SHBA-në, i datës 1.3.1933. Gjyqtari nuk ka përdorur shprehimisht në vendim parime të së drejtës, por referenca ligjore.

Të dhëna dhe vlerësimi

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Paulin Çera nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Paulin Çera përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

Subjekti i rivlerësimit Paulin Çera ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai njih mirë parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, duke përdorur shumë referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë dhe më pak nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale i kushton rëndësi të gjitha elementeve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes të dënimi penal dhe alternativat e tij. Gjithashtu, ai ka njohuri të mira edhe për masat e sigurimit.

Ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar 2 prej tyre. Në të dyja rastet Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, në 3 raste nuk është ushtruar ankim nga palët, ndërsa për tri dokumentet nuk pasqyrohen të dhëna lidhur me ushtrimin ose jo të ankimeve ndaj këtyre vendimeve.

Subjekti i rivlerësimit Paulin Çera ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai i respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i ka përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil apo kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve ai i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe rezulton e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Një konstatim i punës së tij është jo vetëm fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, por edhe përdorimi i fjalive mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

Subjekti i rivlerësimit Paulin Çera, gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer për një periudhë detyrën e gjyqtarit stazhier në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, njëkohësisht në dhomën civile e penale.

Ai ka deklaruar se gjatë 3 viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 413 çështje, ka përfunduar gjithsej 372 çështje për afro 3 vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017, 79 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 90 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtari Paulin Çera ka punuar në këtë gjykatë për periudhën tetor 2014 – qershor 2016 dhe ka përfunduar gjithsej 162 çështje gjyqësore, nga të cilat 3 penale themeli, 17 civile të përgjithshme, 5 familjare, 120 kërkesa civile dhe 17 masa sigurimi.

Sipas pikës 3, germa “a” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është i organizuar në seksione, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në një vit, në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe çështje civile me palë kundërshtarë. Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasimore e gjyqtarit Paulin Çera ka qenë nën standardin minimal.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Paulin Çera ka qenë gjithnjë brenda afateve standarde apo ligjore dhe në intervale kohore nga 2 ditë deri në 2 muaj e 8 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë civile, me objekt “pagim dëmshpërblimi”, e shqyrtuar në 7 seanca. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor është disponuar me vendim për pranimin pjesërisht të padisë, vendim i cili është ankimuar dhe është lënë në fuqi nga gjykata e apelit.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në kryesekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme konstatohet se gjyqtari Paulin Çera ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ai ka pasur ngarkesë sasimore nën standardin minimal, gjithmonë i ka kushtuar rëndësinë e duhur gjykimit në afat, por edhe arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore.

Lidhur me konstatimet e bëra më sipër nga Komisioni, si dhe mbi 5 çështjet, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se: “Në lidhje me çështjen penale në ngarkim të të pandehurit F. A., vendimi i arsyetuar është depozituar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 17.4.2015. Pra, vendimi është depozituar i arsyetuar pas 8 ditësh, duke përfshirë edhe ditët e pushimit (6 ditë pune). Vlerësoj se vendimi është paraqitur në afat dhe afati në këtë rast nuk duhet konsideruar 5-ditor, por 10 ditë. Kemi të bëjmë me një vendim themeli për të cilin zbatohen dispozitat e neneve 379 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe jo neni 113 i këtij Kodi.

Sjell në vëmendje se dispozita e nenit 113 të Kodit të Procedurës Penale është e njëjtë dhe nuk ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017. Ndërsa, po me këtë ligj, dispozita e nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale ka ndryshuar me këtë përmbajtje: ‘...2. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet i plotë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij...3. Kur personi i dënuar është në masë sigurimi personal, sipas neneve 237 dhe 238 të këtij Kodi, vendimi arsyetohet brenda 15 ditëve nga data në të cilën është shpallur ose brenda 30 ditëve kur është gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar...’. Duke analizuar kështu, vlerësoj se nuk kam pasur detyrim që vendimin ta depozitoja brenda afatit 5-ditor, por detyrimi²⁰ ka qenë në afatin 10-ditor, afat i cili është respektuar nga ana ime.

Çështjet e evidentuara nga Komisioni janë shqyrtuar prej meje gjatë kohës që kam kryer stazhin profesional, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (viti i 3-të i Shkollës së Magjistraturës). Gjatë kësaj kohe ka qenë evidente mungesa e sallave e gjykimit, ku të mundësohej regjistrimi audio.

Ndërsa në lidhje me vonesën në fillimin e seancës (40 minuta me vonesë), paretuar shkakun, pa dokumentuar me procesverbal dhe pa regjistrim audio në çështjen që i përket kërkesit I. Sh., sqaroj se kam shqyrtuar dy kërkesa që kanë lidhje me këtë shtetas. Tek njëra paraqitet ai si kërkuar, e ndërsa tek tjetra paraqitet si kërkuar prokuroria, me objekt ‘caktim mase arrest në burg’. Kërkesa e parë është rrëzuar, ndërsa e dyta është pranuar. Vendimi për kërkesën e dytë është shpallur në datën 17.6.2015, ora 15:00, duke u dorëzuar edhe ky vendim në datën 22.6.2015, brenda afatit ligjor. Shqyrtimi i këtyre dy kërkesave në të njëjtën ditë (17.6.2015) dhe mungesa e sallave të gjykimit, pasi kërkuar ka qenë i arrestuar, ka sjellë edhe vonesën në fillimin e seancës²¹. Gjithsesi, mbetet fakt i pakundërshtueshëm se shqyrtimi i këtyre kërkesave, vendimmarrjet dhe dorëzimi i vendimeve është bërë në afat tepër të arsyeshëm”.

Trupi gjykues, pas vlerësimit të përgjigjeve dhe shpjegimeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit, nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin profesional për tri dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe për pesë çështjet e përzgjedhura me short.

GJETJE TË VËZHGUESIT NDËRKOMBËTAR

Vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në datën 15.12.2022, ka paraqitur pranë Komisionit “gjetje” lidhur me subjektin e rivlerësimit Paulin Çera. Trupi gjykues këto gjetje të vëzhguesit ndërkombëtar i bëri pjesë të rezultateve të hetimit në përputhje me nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1) Analiza e çështjes penale lidhur me vendimin nr. *, datë 16.11.2018 edhe në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2017**

²⁰Bashkëlidhur subjekti ka sjellë kopje të njësuar me origjinalin të vendimit penal nr. ***, datë 9.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe fletë regjistri “numëror i vendimeve penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

²¹Bashkëlidhur subjekti ka sjellë kopje të njësuar me origjinalin të vendimit penal nr. ***, datë 17.6.2015, ora 14:15, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe fletë regjistri “numëror i vendimeve penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

a) Përshkrimi i ngjarjeve dhe detajet e historikut procedural të shqyrtuar nga vëzhguesi ndërkombëtar

Vendimi nr. ***, datë 16.11.2018, në lidhje me të pandehurit S.C, I.K, A.Gj etj., është vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën kthim përgjigjeje nr. ***, më 25.10.2022, drejtuar ONM-së.

Me sa rezulton, bazuar në provat e referuara nga Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimeve të Organizuara dhe të Rënda/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, një procedim penal për “shpërdorim detyre” (neni 248 i Kodit Penal) dhe “falsifikim dokumentesh” (neni 186/3 i Kodit Penal) është regjistruar në prokurori. Më shumë se 10 persona u arrestuan dhe u dërguan në paraburgim.

Sipas dosjes rezulton se pas kryerjes dhe përfundimit të veprimeve të nevojshme hetimore paraprahe për procedimin penal nr. ***, viti 2017, Prokuroria e Rrethit Kavajë, e përfaqësuar nga prokurori G.Ç, ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë si vijon:

- i. pushimin e akuzës për shtetasit A.C, F. K, B.P, D.C dhe E.D për “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim dokumentesh”;
- ii. pushimin e akuzës për shtetasen A.Gj për “falsifikim dokumentesh”;
- iii. pushimin e akuzës për shtetasin A.E për “shpërdorim detyre”;
- iv. shfuqizimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitjeje” për shtetasit F.K, B.P, D.C dhe E.D.

Ndërsa, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2018 (Paulin Çera si gjyqtar i seancës paraprahe) i ka kthyer çështjen prokurorit për hetime të mëtejshme, siç përcaktohet në pjesën e arsytimit të vendimit. Hetimi duhet të përfundonte deri më 18.10.2018 dhe seanca e radhës ishte parashikuar të mbahej më 22.10.2018.

Duket se disa deklaratatë të marra nga media të caktuara nuk kanë lidhje me atë që është vendosur.

Në vazhdim të analizës së sipërpërmendur dhe të dosjeve shtesë të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2022, kryesisht për caktimin e masave të sigurimit (për S. C. etj.), si dhe për procedimin penal nr. ***, viti 2017, raportohen edhe gjetjet e mëposhtme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me anë të gjyqtarit të seancës paraprahe Paulin Çera, me vendimin nr.***, datë 18.7.2018, vendosi kthimin në prokurori të dosjes së procedimit penal për hetime të mëtejshme, për t’u plotësuar brenda datës 18.10.2018, siç u citua më lart. Gjithashtu u konstatua se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2018, lëshuar nga gjyqtari Paulin Çera, ka vendosur rrëzimin e kërkesave për zëvendësimin e masës së sigurimit të paraqitur nga të pandehurit S. C. dhe A. Gj. (ky i fundit ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”) dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 13.8.2018, ka gjetur të gabuar vendimin e marrë nga gjyqtari Paulin Çera për rrëzimin e kërkesave të C dhe Gj për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”.

Meqenëse kërkesat e dy të pandehurve u pranuan në Gjykatën e Apelit, 6 të pandehurit e tjerë, N.L, D.K, A.K, A.Xh, I.K dhe A, kanë depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë kërkesat e tyre për zëvendësimin e masës së sigurimit. Me vendimet nr. ***, datë 26.9.2018 dhe nr. ***, datë 5.10.2018, lëshuar nga gjyqtari Paulin Çera për rrjedhojë u vendos pranimi i kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”. Baza e arsytimit në këto dy vendime ka qenë vendimi nr. ***/2018 i Gjykatës së Apelit për C dhe Gj.

Prokuroria ankimoi vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.10.2018, vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 26.9.2018 dhe rrëzimin e kërkesave për të pandehurit N. L, D.K, A.K dhe A.Xh për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Ndërsa me vendimin nr. ***, datë 8.11.2018, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** të Gjykatës së Shkallës së Parë vetëm për të pandehurin A.A dhe ndryshimin e vendimit për të pandehurin tjetër I. K, duke rrëzuar kërkesën e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Me kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Kavajë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, viti 2017 (pas hetimit shtesë të kërkuar nga gjykata më 18.7.2018), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e përfaqësuar nga gjyqtari Paulin Çera, me vendimin nr. ***, datë 16.11.2018, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes në ngarkim të të pandehurve të sipërpërmendur.

b) Komentet shtesë nga vëzhguesi ndërkombëtar

Pavarësisht bindjes së brendshme të gjyqtarit në çështjen në fjalë, subjekti i vlerësimit rezulton se e mbështet rrjedhën e tij të arsyetimit në rastin e vendimit nr. ***, datë 26.9.2018 dhe nr. ***, datë 5.10.2018, bazuar në vendimin nr. ***, datë 13.8.2018, të Gjykatës së Apelit (vendim që zëvendësoi masën e sigurimit për C dhe Gj nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”). Rezulton se subjektit të rivlerësimit i ka munguar arsyetimi dhe analiza e pavarur për secilin rast të të pandehurve, bazuar në rrethanat personale të akuzave.

Kjo është shumë e rëndësishme sepse masat e sigurimit janë të karakterit personal dhe, si të tilla, gjykata – në dhënien e tyre – nuk duhet t’i referohet thjesht vendimeve të tjera gjyqësore që shqyrtojnë një grup tjetër të pandehurish. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për zëvendësimin e masës së sigurimit në pritje të kërkesës së prokurorisë për dërgimin për gjykim të dosjes së procedimit penal, pas vendimit të gjykatës (të subjektit të rivlerësimit) për hetime të mëtejshme. Kjo situatë tregon më së paku mungesën e aftësive të përshtatshme të arsyetimit ligjor që subjekti i rivlerësimit duhet të ketë të paktën në këtë situatë.

Gjykata e Apelit e ka gjetur të gabuar vendimin e subjektit të rivlerësimit për shtetasit N.L, D.K, A.K, A.Xh dhe I.K për pranimin e kërkesës së tyre për zëvendësimin e masave të sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest shtëpie”. Analiza e Gjykatës së Apelit për secilën nga rrethanat e të pandehurve është shqyrtuar në bazë të nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, duke përcaktuar se nëse nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më seriozitetit të fakteve ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.

Gjykata e Apelit ka arsyetuar se i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me ligjin në tjetërsimin e pronave shtetërore, duke dëmtuar kështu interesin ligjor të shtetit në falsifikimin e dokumenteve, se personat e interesuar kanë përfituar kundër ligjit dhe se nuk janë parashikuar rrethana të reja pas caktimit të masës së sigurimit për zbutjen e nevojave të sigurisë dhe, për rrjedhojë, vendimi nuk është bazuar në pikën 2 të nenit 260 dhe në pikën 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale.

Rrethanat familjare dhe çështjet shëndetësore, si dhe kriteret e rrezikshmërisë shoqërore janë shqyrtuar më herët nga gjykata e shkallës së parë, por nuk janë marrë parasysh. Është konsideruar se i/të pandehuri/ët kanë vepruar në një hark kohor të gjatë dhe në bashkëpunim, rrethana të cilat vërtetojnë rrezikshmërinë e lartë të veprës penale në vetvete, se dënimi për këtë vepër penale është 7 vjet dhe se pritshmëritë e vendimit gjyqësor janë me burgim (një arsyetim në rastin e shtetasit I.K, për shembull).

Mësohet nga vendimi nr. ***, datë 16.11.2018, se avokati mbrojtës i njërit prej të pandehurve, D.K, i ka kërkuar gjykatës revokimin e masës së sigurimit, pasi pretendojë se masa e

paraburgimit kishte pushuar. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se Gjykata e Apelit nuk është shprehur në këtë rast për revokimin e masës së sigurimit dhe se bazuar në nenin 263(1), germa “b” dhe pika 2/b, subjekti i rivlerësimit shprehet se afatet për seancën paraprake nuk e kishin humbur fuqinë dhe se kjo ishte përlllogaritur duke qenë në izolim, por subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë arsytim për këtë dhe/ose ndonjë përlllogaritje të ditëve të kaluara në burg.

Neni 263 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se paraburgimi e humb fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dorëzuar aktet në gjykatë: (a) 3 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale; (b) 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim.

Për shtetasin D.K vepra penale dënohet me burgim deri në 7 vjet.

2) Analiza e dosjes së çështjes për shtetasit P. Ç dhe Dh.Z lidhur me procedimin penal nr. */2020**

Nga analiza e dosjes përkatëse rezulton se Prokuroria e Rrethit Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2020 për veprën penale “trafikim i narkotikëve” sipas neneve 238/a/2-22 të Kodit Penal ndaj shtetasit Dh.Z.

Është kryer hetimi dhe pas analizimit të provave të pamjeve filmike është arrestuar edhe shtetasi P.Ç. Nga pamjet filmike mësohet se z. Z kishte parkuar kamionin e tij dhe në parking kishte mbërritur edhe z. Ç me një automjet tjetër. Ata janë takuar bashkë, z. Ç ka hyrë në kamionin e z. Z dhe më vonë secili është larguar.

Sipas z. Z, ai ka pranuar se pakot e heroinës i ka marrë në parking nga një person i panjohur, i cili kishte mbërritur me një automjet tip “***” (vini re se ky informacion nuk konfirmohet nga pamjet filmike).

Në deklarin e tij të dytë, z. Z ka pohuar se e ka takuar z. Ç në parking, i cili kishte mbërritur atje për të marrë disa rroba nga një kamion i parkuar në atë vend që nga tërmeti. Duke qenë se kanë të njëjtin tip kamioni, mësohet se z. Ç ka hyrë në kamionin e tij dhe ka folur për veçoritë e kamionit.

Në deklaratën e tretë të z. Z, ai ka deklaruar se nuk ka thënë të vërtetën, por se çantën e kishte gjetur jashtë shtëpisë dhe ka vendosur ta shesë jashtë shtetit për përfitime ekonomike.

Pas hetimeve nga prokuroria, prokurori i çështjes vendosi dërgimin në gjykatë të procedimit penal, por vetëm për z. Z dhe pushimin e hetimeve për shtetasin P.Ç, pasi u deklarua se nuk u gjetën prova për ta akuzuar atë si bashkautor (mund të jetë e rëndësishme të theksohet se oficeri i policisë gjyqësore në raportin e tij rekomandoi dërgimin e çështjes për gjykim për të dy të pandehurit).

Sipas arsytimit gjyqtari Paulin Çera në vendimin e tij, i cili konfirmoi konkluzionet e prokurorit të çështjes, çmon se z. Ç nuk shpallet fajtor dhe se nuk mund të akuzohet vetëm për faktin se shfaqet në pamjet filmike duke u takuar me z. Z, megjithëse subjekti i rivlerësimit pranon në vendimin e tij se ky fakt mbetet i dyshimtë dhe gjithashtu se z. Z e ka mohuar që z.Ç t'i kishte dorëzuar pakot e heroinës ose të ishte bashkautor.

Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka vlerësuar apo arsyetuar mbi faktin se i pandehuri ka dhënë versione të ndryshme në deklarin e tij (dhe kryesorja është se pakot e heroinës i ka marrë nga dikush që ka mbërritur me automjetin tip “***”, kjo e fundit nuk konfirmohet nga pamjet filmike), prandaj mund të konkludohet në përgjithësi nga deklarin e ndryshme të z.Z shqyrtimi i pamjeve filmike dhe gjetja e një celulari të koduar të mbështjellë me gazetë (ku u konstatua një gjurmë e pidentifikuar) se kjo veprë penale është kryer në bashkëpunim.

Në çdo rast, mungesa e një vlerësimi të duhur të provave të disponueshme (p.sh. deklarime të ndryshme të dhëna me kalimin e kohës) nuk shkon në favor të subjektit të rivlerësimit, por më tepër në dëm të tij.

Konkluzion

Vëzhguesi ndërkombëtar është i mendimit se këto gjetje ndikojnë në vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit për sa i përket arsyetimit ligjor dhe aftësisë për të trajtuar çështjet, ku të gjitha janë të rëndësishme për vlerësimin e aftësive profesionale dhe vlerësimin tërësor.

Më konkretisht, mungesa e arsyetimit ligjor të individualizuar në vendimin për masat e sigurimit në rastin e parë, si dhe mungesa e trajtimit të provave kontradiktore, deklaratimet e ndryshme, në rastin e dytë, janë elemente që nuk mund të konsideroheshin pozitivisht në kuadër të këtij procesi rivlerësimi.

Për gjetjet e bëra nga vëzhguesi ndërkombëtar si pjesë e rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Për dhënien e një përgjigjeje të saktë dhe në përputhje me ligjin nga ana ime, sjell në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit²².*

*Në lidhje me çështjen e parë (gjetjen), që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2017, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Kavajë, sqarohet se të gjithë të pandehurit janë dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë (gjyqtari i themelit) sipas akuzave të përcaktuara nga gjyqtari i seancës paraprake. E ndërsa gjykata e themelit i ka dënuar pothuajse të gjithë të pandehurit vetëm me dënim me burg (shihni vendimin nr. ***, datë 10.4.2019), Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 1.11.2019, ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, duke aplikuar për disa nga të pandehurit alternativa të vuajtjes së dënimit.*

Duke pasqyruar sa më sipër, në përgjigje të konkluzionit të vëzhguesit ndërkombëtar për mungesë arsyetimi të individualizuar në vendimin e masave të sigurimit, vlerësoj sa vijon:

- 1. Në vendimet penale nr. ***, datë 5.7.2018 (kërkues A.A) dhe nr. ***, datë 31.7.2018 (kërkues S.C dhe A.Gj), kam arsyetuar në mënyrë individuale, për secilin nga të pandehurit, konform parashikimeve të nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, në raport me nevojat e sigurimit, përshtatshmërinë e masave të sigurimit dhe veprave penale për të cilat ishin akuzuar. Kjo tregon nivelin e arsyetimit në harmoni me provat e administruara, si dhe me rëndësinë e faktit penal.*
- 2. Me vendimin penal nr. ***, datë 13.8.2018, Gjykata e Apelit Durrës e ka gjetur të gabuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, sa i përket të pandehurve C dhe G. Personalisht ndaj mendimit se ky vendim nuk u përgjigjej nevojave të sigurimit, sa i përket çështjes penale nr. *** të vitit 2017, të regjistruar nga Prokuroria Kavajë. Rrethanat e shqyrtuara në këtë vendim kanë qenë të marra në konsideratë edhe më parë, kur të pandehurve u është caktuar masa e sigurimit arrest në burg apo u është rrëzuar kërkesa për zëvendësim të masës së sigurimit. Kujtojmë këtu se i pandehuri S.C paraqitej person me rrezikshmëri të lartë shoqërore, pasi në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë kryeregjistruar.*
- 3. Pavarësisht mendimit që ndaj në këtë rast, vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të jetë detyrues për gjykatën më të ulët. Në praktikën time, në asnjë rast nuk kam dhënë vendime*

²²Shihni vendimin nr. 16, datë 13.7.2020, të Kolegjit.

në kundërshtim me vendimin e një gjykate më të lartë. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Apelit kishte të bënte me një çështje që isha caktuar si gjyqtar i seancës paraprahe.

- 4. Me rastin e marrjes së vendimeve nr. ***, datë 26.9.2018 (kërkesa e shtetasve N.L, D.K, A.Xh dhe A. K) dhe nr. ***, datë 5.10.2018 (kërkesa e shtetasve I. K dhe A. A), është e vërtetë që i jam referuar dhe kam vendosur si bazë në vendimmarrje vendimin nr. ***, datë 13.8.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, por që nuk jam mjaftuar vetëm me këtë vendim. Në arsyetim të këtyre vendimeve rezultojnë të jenë marrë në konsideratë edhe rrethanat individuale për secilin të pandehur, sipas parashikimeve të nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe jurisprudencës vendëse dhe të huaj.*
- 5. Është e vërtetë se këto vendime janë marrë përpara datës 22.10.2018, datë e caktuar për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim, por, së pari, nuk kam pasur dijeni nëse nga ana e prokurorisë ishin kryer të gjitha detyrat e caktuara nga gjykata, pasi e kundërta mund të çonte në caktimin e një afati tjetër për plotësimin e tyre dhe, e dyta, kam qenë para kërkesave penale për zëvendësim/revokim mase, kërkesa të cilat paraqesin ngutshmëri në shqyrtimin e tyre.*
- 6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.10.2018, ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës së të pandehurve N.L, A. K D.K dhe A.Xh për zëvendësimin e masës së sigurimit arrest në burg. Është po kjo Gjykatë që, me vendimin nr. ***, datë 8.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 5.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për të pandehurin A.A, duke e ndryshuar vendimin për të pandehurin I.K dhe rrëzuar kërkesën e tij për zëvendësim mase sigurimi. Arsyetimi i shkallës së parë në të dyja rastet ka qenë i njëjtë, por vlerësimi është i ndryshëm nga Apeli.*
- 7. Fakti që në praktikën time të punës zbatoj vendimet e një gjykate më të lartë, e kam shprehur edhe me vendimin nr. ***, datë 16.11.2018, ku me rastin e pranimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjyq të procedimit penal, kam vendosur rrëzimin e kërkesave penale për revokim apo zëvendësim mase sigurimi personal të paraqitur nga të pandehurit D.K, A. K, A. Xh, N.L dhe I.K. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 14.12.2018.*
- 8. Gjykata e themelit në Kavajë dhe ajo e Apelit në Durrës i kanë dënuar të gjithë të pandehurit sipas akuzave të cilësuar saktë në seancë paraprahe.*
- 9. Sa i përket të pandehurit D.K, për revokim mase sigurimi, për shkak të mbarimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 263/1/b të Kodit të Procedurës Penale, në vendimin nr. ***, datë 16.11.2018, jam shprehur tekstualisht: 'Gjykata vëren se ky kërkim është i pabazuar, pasi së pari Gjykata e Apelit Durrës në vendimmarrjet e mësipërme e ka pasur mundësinë që, nëse një afat i tillë ka kaluar, të vendoste për revokimin e masës së sigurimit; dhe së dyti, gjykata në referim të nenit 263, pika 1, germa 'b' dhe pika 2, germa 'b', vlerëson se afati i paraburgimit për të pandehurin D.K nuk e ka humbur fuqinë. Në vlerësimin e gjykatës, paraburgimi në këto raste duhet llogaritur me kohëqëndrimin fizikisht në kushtet e izolimit, pa aplikimin e nenit 57 të Kodit Penal, i cili gjen zbatim në caktimin përfundimtar të dënimit për të pandehurin'.*
- 10. Kundër vendimit të mësipërm rezulton se është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 14.12.2018, duket se ka pranuar arsyetimin e shkallës së parë. Ajo është shprehur se: 'Edhe pretendimi i të pandehurit D.K se masa e sigurimit arrest në burg është shuar, pasi ka më shumë se 6 muaj në paraburgim dhe çështja nuk ka shkuar për gjykim brenda këtij afati, është i pabazuar (citohet neni 263/1/b i Kodit të Procedurës Penale). Afati i paraburgimit të kryer prej tij nga data 13.11.2017 deri më 26.9.2018*

llogaritet si masë dënimi në rast se i pandehuri do të dënohet për veprën e dyshuar, por jo për efekt të shuarjes së masës së arrestit në burg sipas nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, fillimi i llogaritjes së afatit të paraburgimit fillon në momentin e dytë të caktimit të masës arrest në burg, që është data 31.10.2018, me vendimin e Gjykatës së Apelit. Nga ky moment nuk rezulton që i pandehuri D.K të ketë qëndruar më shumë se 6 muaj në paraburgim dhe, në këto kushte, me të drejtë nga gjykata e shkallës së parë masa e sigurimit arrest në burg për të nuk është shuar. I njëjti argument është edhe për të pandehurit e tjerë në lidhje me shuarjen e masës së sigurimit”.

Në lidhje me çështjen e dytë (gjetjen), që i përket çështjes penale që i përket procedimit penal nr. ***/2020, në ngarkim të të pandehurit Dh.Z dhe personit nën hetim P. Ç, subjekti shpjegon se: “Në datën 21.1.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka depozituar në gjykatë kërkesat penale me objekt: ‘1. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, datë 18.5.2020, në ngarkim të të pandehurit Dh.Z, i akuzuar për kryerjen e veprës penale ‘trafikim i narkotikëve’, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal. 2. Pushimin e hetimeve në procedimin penal nr. ***, datë 18.5.2020, të personit nën hetim P.Ç, për veprën penale ‘trafikim i narkotikëve’, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal’. Me shortin elektronik të datës 22.1.2021 më është caktuar për shqyrtim, ndërsa kjo çështje është përfunduar brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 332/3 i Kodit të Procedurës Penale.

*Në përgjigje të konkluzionit të vëzhguesit ndërkombëtar për mungesë arsyetimi, sa i përket trajtimit të provave kontradiktore – deklaratimet e ndryshme, në çështjen që i përket procedimit penal nr. ***/2020, vlerësoj sa vijon:*

- 1. Me ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale, me ligjin nr. ***/2017, datë 30.3.2017, gjyqtari i seancës paraprake nuk e ka kompetencën funksionale për të bërë vlerësimin e provave, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim. Përpara se të merret vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake ka detyrimin të analizojë kryesisht nëse kjo kërkesë është e bazuar në prova dhe ligj, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë së akteve procedurale (absolute kryesisht dhe relative me kërkesë të palëve). Gjithashtu, duhet të analizojë ekzistencën e faktit penal dhe lidhjen e të pandehurit me këtë fakt penal, si dhe faktin nëse cilësimi juridik i bërë nga prokuroria faktit penal është i drejtë.*
- 2. Gjyqtari i seancës paraprake shqyrton kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq dhe, nëse ka edhe kërkesë për pushim akuze, ato gjykohen bashkërisht. Në këtë rast, gjyqtari duhet t’u referohet provave të administruara gjatë hetimeve paraprake, kërkesës së prokurorit dhe bazës ligjore të parashtruar prej tij. Mbi këtë bazë, gjyqtari i seancës paraprake duhet t’i referohet germës së nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, për të cilën është kërkuar pushimi dhe, në raport me provat e administruara, ta analizojë atë.*
- 3. Në çështjen konkrete, prokuroria ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Dh.Z, ndërsa ka kërkuar pushimin e hetimeve për personin nën hetim, pasi nuk ka arritur t’i provojë akuzën. Kërkesa e prokurorit është konfirmuar edhe me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë.*
- 4. Është e vërtetë se oficeri i policisë gjyqësore, në relacionin nr. ***/2020 mbi përfundimin e hetimeve të procedimit penal, ka kërkuar dërgimin për gjykim për veprën penale ‘trafikim i narkotikëve’, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2*

i Kodit Penal. Në nenin 327/1 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se: '1. Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve'. Duke e parë në tërësi relacionin e OPGJ-së, vërehet lehtësisht se ai ka bërë një renditje të veprimeve hetimore të kryera dhe atyre të deleguara, por nuk ka dhënë ndonjë sugjerim (arsyetim) se përse kjo vepër penale është kryer në bashkëpunim, cilët janë bashkëpunëtorët, veprimet e secilit prej tyre dhe provat që e provojnë këtë vepër penale. Për më tepër, në relacionin e tij, OPGJ-ja harron se ky procedim penal është regjistruar për një vepër penale të mbetur në tentativë.

5. *Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në seancë paraprake, gjykata i ka gjetur të drejta kërkimet e prokurorisë, duke i miratuar ato. Provat kanë qenë të mjaftueshme për të pandehurin Z për t'i provuar akuzën dhe ashtu ka ndodhur, pasi ai është dënuar me 10 vite burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe e Apelit Durrës, ndërsa për personin nën hetim Ç provat e paraqitura jo vetëm që nuk ishin të mjaftueshme, por në gjendjen që ato ndodheshin, nuk i provohej akuzat. Në vlerësimin tim, kërkesa e prokurorit është pranuar me të drejtë.*
6. *I pandehuri Dh.Z është pyetur tri herë gjatë hetimeve paraprake dhe në çdo rast ka dhënë deklaratime të ndryshme. Ai u pyet edhe nga gjyqtari i seancës paraprake. Deklarimet e tij kontradiktore në asnjë moment nuk kanë përfshirë personin nën hetim P. Ç. Edhe sikur të vlerësoheshin ndryshe këto deklaratime, përfshirë edhe deklaratimin e parë të dhënë prej tij (më afër të vërtetës), përsëri nuk të çonin në provën që bashkëpunimin në trafikun e narkotikëve ta ketë me shtetasin P.Ç.*
7. *Në vendimin e saj, Gjykata e Apelit Durrës i ka vlerësuar të gjitha deklaratimet e të pandehurit Dh.Z, duke u përqendruar me të drejtë në deklaratimin e parë të dhënë prej tij dhe në përfundim ka konkluduar se veprën penale nuk e ka kryer i vetëm, por me persona të tjerë të pidentifikuar, për të cilët prokuroria ka ndarë çështjen dhe po vijon hetimet. Ky arsyetim i Gjykatës së Apelit është pothuajse i njëjtë me arsyetimin e gjyqtarit të seancës paraprake.*
8. *Ndaj mendimin se deklaratimet kontradiktore të dhëna nga i pandehuri Z nuk ka se si të vlerësoheshin ndryshe nga gjyqtari i seancës paraprake.*
9. *Me kompetencën që i njeht ligji procedural penal, gjyqtari i seancës paraprake, në vendimin e tij nr. ***, datë 5.2.2021, pasi ka evidentuar ndarjen e këtij procedimi penal, ka sjellë në vëmendje parashikimet e nenit 329/c të Kodit të Procedurës Penale, sa i përket revokimit të vendimit të pushimit për personin nën hetim P.Ç, nëse nga hetimet që po kryhen do të dalin prova të tjera. Pra, ky vendim është i revokueshëm në çdo moment, mjafton të dalë një provë e re dhe prokuroria të ketë vullnetin për ta hetuar këtë procedim...”.*

Vlerësimi i Komisionit për dy gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë

- Në lidhje me shpjegimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit që ka të bëjë me çështjen e parë (gjetjen), që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2017, trupi gjyqësor doli në përfundimin se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm faktin përse vendimet e tij për zëvendësim masash sigurimi kanë qenë të ndryshme gjatë vendimmarrjeve të tij. Në rastin e marrjes së vendimeve nr. ***, datë 26.9.2018 (kërkesa e subjekteve N. L., D. K., A. Xh. dhe A. K.) dhe nr. ***, datë 5.10.2018 (kërkesa e I. K. dhe A. A.), subjekti i është referuar në vendimmarrje vendimit nr. ***, datë 13.8.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës, vendim i cili nuk është shprehur për ndryshim mase edhe për këta të pandehur.

Subjekti ka ndryshuar masën për këta persona, edhe pse nuk kishin ndryshuar rrethanat dhe faktet që nga vendimi i tij i parë për masën e sigurisë.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.10.2018, ka ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës për të pandehurit N. L., A. K., D. K. dhe A. Xh. për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

- Ndërsa në lidhje me gjetjen e dytë (në çështjen që i përket procedimit penal nr. ***/2020), trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë plotësisht arsyetimin për faktin se i pandehuri P. Ç. ka dhënë versione të ndryshme në deklaratimet e tij. Kjo për sa i përket trajtimit të çështjes bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit përfundimtar në vendimin e dhënë.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në seancë paraprake, gjykata i ka gjetur të drejta kërkesat e prokurorisë për të pandehurin Z, me akuzën për kryerjen e veprës penale “trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Apelit Durrës ky shtetas është dënuar me 10 vite burgim.

Për ndarjen e procedimit penal, gjyqtari i seancës paraprake i është referuar legjislacionit procedural penal në fuqi (vendimi nr. ***, datë 5.2.2021). Pasi ka evidentuar ndarjen e këtij procedimi penal dhe ka sjellë në vëmendje parashikimet e nenit 329/c të Kodit të Procedurës Penale, sa i përket revokimit të vendimit të pushimit për personin nën hetim P.Ç, gjyqtari referon se, nëse nga hetimet që do të kryeshin nga prokuroria do të dalin prova të tjera, atëherë mund të fillojë edhe çështje penale ndaj personit tjetër P. Ç. Ky vlerësim nuk duhet të ishte lënë në çmim të prokurorit, por subjekti duhet t'i linte detyra konkrete prokurorisë lidhur me hapat dhe hetimet që duhet të kryente edhe për këtë shtetas.

Në përfundim, trupi gjykues, pavarësisht vlerësimit lidhur me mënyrën se si ka proceduar subjekti në këto 2 çështje, çmon se këto veprime nuk përbëjnë shkak që të mund të cenojnë figurën e magjistratit, në kuptim të vlerësimit të aftësive profesionale të tij.

DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit Paulin Çera janë paraqitur 10 denoncime.

1. Denoncim i shtetasit S.T (nr. *** prot., datë 7.12.2017; nr. *** prot., datë 15.11.2018; nr. *** prot., datë 22.5.2019; nr. *** prot., datë 22.5.2019; nr. *** prot., datë 28.7.2020; nr. *** prot., datë 10.5.2021), i cili ka denoncuar disa subjekte të rivlerësimit, ndër të tjerë edhe subjektin Paulin Çera.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi nuk vërehen fakte apo rrethana të tilla që të përbënin prova për gjetje, mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Paulin Çera, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko-profesional.

2. Denoncim i shtetasit H.M (nr. *** prot., datë 22.12.2021; nr. *** prot., datë 27.4.2018), i cili denoncon subjektin e rivlerësimit për mosrespektim të ligjit, zvarritje procesi dhe moskryerje hetimi të plotë. Denoncuesi ka paraqitur një vendim gjyqësor të subjektit.

Sipas këtij vendimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen me nr. *** vendimi, datë 1.10.2019. Rezultoi nga praktika për këtë çështje se denoncuesi ka ngritur padi ndaj AKKP-së në vitin 2012. Subjekti i rivlerësimit ka marrë në gjykim çështjen ndaj denoncuesit në vitin 2016 dhe ka njoftuar palët ndërgjyqëse në datën 28.10.2016. Me vendimin nr. ***, datë 1.10.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Duket se kjo çështje ka zgjatur përtej një afati të arsyeshëm dhe duket se nuk është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Për vonesën në shqyrtimin e kësaj çështjeje subjektit të rivlerësimit iu kërkuar shpjegime dhe, në përgjigje të rezultateve të hetimit, parashtrou: “Në datën 23.10.2012, paditësit F.M, A. M, I.M, M.M, Xh.M dhe S.M, të përfaqësuar nga H.F.M sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 27.9.2007, kanë paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesëpadinë me objekt ‘shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit nr. ***, datë 19.9.2012, të AKKP-së Tiranë; njohjen e së drejtës, të kthimit dhe kompensimit të pronës, të sip. 86.055 m² tokë bujqësore, sip. 4,000 m² truall dhe sip. 6,360 m² kullotë, të ndodhura në fshatin Gj, komuna I, qarku Durrës’, duke thirrur në cilësinë e të paditurit Agjencinë e Trajtimit të Pronave Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka zhvilluar disa seanca gjyqësore, në datën 20.11.2014 ka marrë vendimin nr. ***, duke vendosur të shpallë moskompetencën tokësore për gjykimin e kësaj çështjeje civile, duke ia dërguar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo çështje i është caktuar gjyqtarës M. M. Duke qenë se gjyqtarja nuk është paraqitur në punë për shkak të gjendjes shëndetësore dhe sipas raportit për leje barrë lindjeje, kjo çështje është rishortuar, duke i kaluar për gjykim këtij trupi gjykues në datën 27.10.2016.

Nisur nga praktika e asaj kohe, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 27.2.2017, ka vendosur: ‘1. Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për shqyrtimin e çështjes civile nr. (***) ***, datë regjistrimi 5.3.2015. 2. Dërgimin e akteve pranë Gjykatës së Apelit Durrës si gjykata kompetente’. Me vendimin nr. ***, datë 18.12.2017, Gjykata e Apelit Durrës ka parashtruar në Gjykatën e Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës. Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 14.2.2018, ka vendosur: ‘prishjen e vendimit nr. (***) ***, datë 27.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e çështjes pranë asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit’. Në datën 15.5.2018, kjo çështje ka ardhur përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke iu caktuar të njëjtit trup gjykues.

Me marrjen e kësaj çështjeje, gjykata caktoi seancën gjyqësore duke ftuar palët ndërgjyqëse. Gjatë gjykimit u konstatua se paditësit F.M, A.M dhe I.M kishin ndërruar jetë dhe, në bazë të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile, u bë kalimi procedural tek trashëgimtarët e tyre. Të gjithë palët paditëse u përfaqësuan në gjykim nga H.M i zgjedhur me akt përfaqësimi, si dhe me deklaram në seancë gjyqësore sipas parashikimeve të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, shtetasja S. K paraqiti kërkesën për ndërhyrës kryesor, duke pretenduar të njihet pronare për një sipërfaqe prej 1,830 m² në pjesën që pretendon paditësi për njohjen dhe kthimin e saj, pasi kjo sipërfaqe është blerë me aktmarrëveshjen e datës 7.12.1985, të lidhur ndërmjet shitësit F. M dhe blerësit A.K, si dhe është fituar me AMTP-në nr. ***, datë 10.5.2005. Në bazë të nenit 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, gjykata vendosi të pranojë si ndërhyrës kryesor shtetasen S. K kundërpadinë, pasi vlerësoi se ka lidhje me padinë objekt shqyrtimi. Nga procesverbalet e seancave²³ (nga data 6.6.2018 – 1.10.2019) konstatohen arsyet e shtyrjeve. Duke parashtruar sa më sipër, sjell në vëmendje të Komisionit se kjo çështje është marrë në shqyrtim nga ana ime në datën 15.5.2018 dhe e kam përfunduar në datën 1.10.2019. Pra, është përfunduar në një afat afërsisht 1 vit e 5 muaj, nga të cilat duhet të zbriten 2 muaj (gusht) për shkak të pushimeve. Nga procesverbalet e seancave konstatohet se unë nuk jam bërë shkak për zvarritjen e këtij gjykimi, me përjashtim të seancës së datës 16.11.2018, kur kam qenë i deleguar në një gjykatë tjetër për shqyrtimin e një çështjeje penale me shumë të pandehur, nga të cilët një pjesë të arrestuar. Vetë paditësi është bërë shkak për zvarritjen e këtij gjykimi, duke kërkuar shtyrje të seancave dhe, në raste të tjera, për shkak të moskorrektësisë së tij për të përcaktuar adresat e trashëgimtarëve ligjorë të disa prej paditësve që kishin ndërruar jetë. Në vlerësimin tim, kjo çështje është shqyrtuar brenda afatit të arsyeshëm, nisur nga fakti se kjo çështje ishte depozituar në gjykatë që në vitin 2012 dhe

²³Shihni bashkëlidhur procesverbalet e seancave gjyqësore.

akoma nuk kishte gjetur zgjidhje. Sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, kam bindjen se kam vepruar drejt. Në dijeninë time, kjo çështje ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës”.

3. Denoncim nr. * prot., datë 22.5.2018, i shtetases O.V,** e cila denoncon subjektin e rivlerësimit për një proces të parregullt ligjor dhe paanësi në gjykim.

Sipas denoncueses, subjekti ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, ka toleruar sjelljen jokorrekte të përfaqësuesit të prokurorisë dhe anashkalimin për dëgjimin e palëve të treta të thirrura në gjykim. Për këtë denoncim u kërkua praktika gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me shkresën nr. ***, datë 4.10.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar pranë Komisionit praktikën që i përket çështjes gjyqësore me palë ankimuese shtetases O.V. Nga dokumentacioni rezultoi se ankuesja nëpërmjet studios ligjore “****” ka paraqitur (në datën 18.1.2018) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ankimin kundër vendimit nr. ***, datë 4.1.2018, të Prokurorisë së Rrethit Durrës, për mosfillimin e procedimit penal. Në datën 23.1.2018, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore që do jetë në datën 6.2.2018, ora 10:00. Në njoftimin e bërë për palët është caktuar ora e seancës gjyqësore, 11:00. Më 9.2.2018 është kërkuar nga subjekti tërheqja e fashikullit hetimor që i përket vendimit nr. ***, datë 4.1.2018. Me anë të një shkrese që mban datën 20.2.2018 (data me shkrim dore), subjekti ka njoftuar Drejtuesen e Prokurorisë së Rrethit Durrës për mosparaqitjen e prokurorit në seancën e datës 16.2.2018. Këtë fakt subjekti e ka reflektuar edhe në procesverbalin e seancës së datës 16.2.2018, duke caktuar edhe seancën e radhës, në datën 23.2.2018. Prokuroria e Rrethit Durrës, me shkresën nr. ***, datë 21.2.2018, ka kthyer përgjigje, ku thekson se mospjesëmarrja e prokurorit në seancën gjyqësore të datës 16.2.2018 ka ndodhur për shkak të ndjekjes së 2 proceseve të tjera gjyqësore të paplanifikuara. Bazuar në procesverbalin e seancës së datës 23.2.2018 rezultoi se prokurori i çështjes ka qenë prezent dhe kjo seancë është zhvilluar në prani të palëve pjesëmarrëse. Në përfundim të seancës së datës 23.2.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “rrezimin e kërkesës” së ankueses O.V, duke cituar se kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. *** (***), datë 16.5.2018, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit penal nr. (***) ***, datë 23.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
- Pranimin e ankimit të ankueses O. L.
- Prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 4.1.2018 “Për mosfillimin e procedimit penal mbi materialin kallëzues nr. ***, datë 3.1.2018”.
- Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Durrës të regjistrojë procedimin penal dhe të vazhdojë hetimet.

Pra, rezultoi se vendimi i subjektit të rivlerësimit është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës.

4. Denoncim nr. * prot., datë 23.10.2018, i shtetasit A.I.H** i cili ndër të tjerë, denoncon subjektin e rivlerësimit për gjykim jo të drejtë, për proces jo të rregullt ligjor, pasi nuk ka marrë në konsideratë asnjë kërkesë të denoncuesit.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi nuk vërehen fakte apo rrethana të tilla që të përbënin prova për gjetje, mbi bazën e të cilave do të mund të vlerësohej veprimtaria e subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Paulin Çera, për aspekte që lidhen me vlerësimin e kriterit etiko-profesional. Çështjet e ngritura nga denoncuesi lidhur me subjektin e rivlerësimit janë objekt ankimi dhe shqyrtimi në Gjykatën e Apelit.

5. Kallëzim penal nr. * prot., datë 26.9.2019, i shtetasit P.R.** Kjo kërkesë nuk është paraqitur si denoncim, por kallëzim penal ndaj disa subjekteve të rivlerësimit për korrupsion pasiv, shpërdorim detyre dhe grup të strukturuar kriminal. Kallëzimi penal i është drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm dhe për dijëni Komisionit. Nuk rezulton ndonjë denoncim i paraqitur ndaj subjektit, por material kallëzues në prokurori.

6. Kërkesë ankimore nr. * prot., datë 22.10.2019, e shtetasit R.Sh,** në të cilën ky shtetas ka përmendur edhe subjektin e rivlerësimit si gjyqtar i korruptuar. Në këtë ankim nuk paraqiten fakte apo ndonjë vendim gjyqësor për t'u analizuar.

7. Ankim i shtetasit F.K (nr. *** prot., datë 18.5.2020; nr. *** prot., datë 30.7.2020; nr. *** prot., datë 8.9.2020), i cili u drejtohet titullarëve të KLGJ-së dhe KLP-së dhe për dijëni Komisionit. Ankuesi ankohet lidhur me vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës së bërë ndaj disa subjekteve të rivlerësimit dhe subjektit Paulin Çera. Nuk rezultuan problematika apo çështje për analizim nga Komisioni për këtë ankesë.

8. Denoncim nr. * prot., datë 13.4.2021, i shtetasit F.Gj,** i cili është parashtruar në formën e kërkesës drejtuar kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për dorëheqjen e subjektit Paulin Çera nga çështja gjyqësore ku denoncuesi është palë. Nuk rezultuan problematika apo çështje për analizim nga Komisioni për këtë ankesë.

9. Ankesë nr. * prot., datë 16.6.2020, e shtetasit R.D,** i cili ka shfaqur shqetësim lidhur me vendimmarrjen për dy çështje gjyqësore, ku njëra çështje është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit. Ankuesi ka bindjen se në shpalljen e vendimeve gjyqësore kanë ndikuar elemente të tjera dhe jo zbatimi me korrektësi profesionale i ligjit, për të realizuar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka shqyrtuar çështjen gjyqësore të vitit 2019, për veprat penale “vjedhje me pasoja të rënda” dhe “shpërdorim detyre”. Me vendimin nr. ***, datë 8.7.2019, është vendosur “pushimi i çështjes penale në ngarkim të të pandehurve”. Ky vendim i subjektit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës në datën 27.11.2019, ku është referuar dhe ankimi në Gjykatën e Lartë kundër këtij vendimi. Ankesa e paraqitur nga shtetasi Ramazan Domi ka të bëjë me vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë (të subjektit të rivlerësimit) dhe Gjykatës së Apelit Durrës, e cila mund të ndiqet nëpërmjet mjeteve të ankimit dhe kryesisht me anë të rekursit në Gjykatën e Lartë.

10. Denoncim nr. * prot., datë 2.11.2022, i shtetas V. A,** paraqitur në Komision nga ONM-ja. Denoncuesja ka paraqitur një ankesë ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Durrës për cenim dhe shkelje të rëndë të standardeve për një proces të rregullt ligjor, si dhe për abuzim të rëndë me ligjin. Ankimi lidhur me subjektin duket se ka të bëjë me vendimmarrjen e tij në këtë çështje, e cila mund të ndiqet nëpërmjet ankimit gjyqësor. Gjithsesi, për këtë denoncim është kërkuar me shkresën nr. *** prot., datë 4.11.2022, praktika gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që i përket çështjes penale ndaj të akuzuarit K.E. Me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka paraqitur kopje të vendimit gjyqësor nr. (***) ***, datë 28.12.2017, duke theksuar se dosja dhe çështja gjyqësore është për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me gjetjet e bëra nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, shpjegimet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit (për 2 çështjet gjyqësore) nuk ishin bindëse. Për këto 2 çështje

janë konstatuar disa mangësi të subjektit, por që nuk vlerësohen nga trupi gjykues për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Paulin Çera ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, referuar germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Paulin Çera, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.1.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

